


92.
R.57



Sami
FRASHËRI

TIRANË 1962

92

R:57

ESAD RESO

S.

~~31564~~
BIBLIOTEKA E SHKOLLËS
GJERGJ KASTRI
23677

SAMI FRASHËRI

PIKEPAMJET FILOZOFIKE, SHOQERORE
DHE POLITIKE

N. Sh. Botimeve «NAIM FRASHËRI»
Tiranë, 1962


Redaktor: Alqi Kristo.
Korektor letrar: Reshat Këllçi
Kopertina nga: Dolli Gjinali.
Redaktor teknik: Adem Lita

Tirazhi: 2500

Format 78/109/32

Stash: 2204-55

Shtyp. N.I.Sh. Shtypshkronjave «MIHAL DURI» — Tiranë



Sami Frashëri.

H Y R J E

Ky studim ka për qëllim të tregojë figurën e vërtetë të patriotit, demokratit dhe mendimtarit të shqar revolucionar shqiptar Sami Frashërit, ideologut të lëvizjes kombëtare shqiptare të gjysmës së dytë të shekullit XIX.

Para çlirimit të Shqipërisë dhe vendosjes së pushtetit popullor puna shkencore dhe veprimtaria përparimtare e Samiut ishin lënë mënjanë.

Partia e Funës e Shqipërisë qysh në fillim të veprimtarisë së saj ka vlerësuar drejt traditat e shkëlqyerë dhe trashëgiminë kulturale artistike të popullit tonë duke zbatuar kësish mësimet e Leninit, që thotë se kultura proletare duhet të jetë zhvillimi i ligjshëm i të gjithë thesarit të diturisë që ka përpunuuar njerëzimi.

Vendimi i Komitetit Qëndror të P. P. SH. «Mbi traditat patriotike - revolucionare të popullit tonë dhe masat për njohjen dhe zhvillimin e tyre të mëtejshëm», ka patur një jehonë të madhe. Në bazë të këtij vendimi po ngrihen monumente për Skënderbeun, Naim Frashërin, Sami Frashërin, Ali Kelmendin etj. dhe po botahen broshura të veçanta shkencore-popullore mbi jetën dhe veprimtarinë e figurave të shquara të së kaluarës.

Në këtë mënyrë ky studim «Mbi pikëpamjet filozofike dhe politike - shoqërore të Sami Frashërit» është një përpjekje, për t'u përgjegjur kërkesave dhe detyrës që shtron vendimi në fjalë.

Samiu ka dhënë një kontribut të madh në historinë e mendimit të vendit tonë. Duke marrë parasysh punën dhe veprat e shumta me vlerë të këtij mendimtari dhe ideologu përparimtar patriot dhe revolucionar, studimet

që janë bërë deri më sot janë të pakta, sidomos në lëmin e filozofisë, gjë që e vështirëson punën e një studimi si ky, aqë më tepër kur shumë vepra të Samiut ndodhen të shkruara turqisht.

Analiza e veprimitarise së mendimtarit shqiptar në kushtet historike dhe konkrete, në të cilat ai jetoi dhe punoi, do të jetë e dobishme, së pari për ta njojur më mirë atë, dhe së dyti për t'u treguar disa ideologjëve të borgjezisë turke që përpinqen ta paraqesin atë si shkençtar dhe ideolog turk, se ai ka qenë përmbi të gjitha shqiptar.

Puna e Sami Frashërit në lëmin e kulturës turke dhe arabe ka karakter shkencor. Ai i ka kushtuar një vëmëndje të veçantë studimit të historisë, kulturës e gjuhëve të popujve të Lindjes dhe ka lënë një varg veprash të rëndësishme në këtë drejtim.

Veprimitarinë publicistike-politike të Sami Frashërit për shërimin e atdheut të tij e ka njojur çmuar edhe shkencëtari rus akademiku Vl. Gordlevskij 50 vjet më parë.

Lëvizja e rilindjes sonë kombëtare ka lojtur një rol të madh në luftën e popullit shqiptar për bashkimin e tij kombëtar, pavarësinë dhe përhapjen e arsimit. Prej vitit 1836 deri më 1912, a'o shënoi suksese të dukeshme.

Shqipëria për një kohë të gjatë, duke u gjëndur nën zgjedhën turke, mbeti shumë mbrapa nga vendet e tjera evropiane. Aty nga gjysma e parë e shekullit XIX në Shqipëri filluan të lindin në formë mjaft të kufizuar marrëdhëni kapitaliste. Por megjithëkëtë marrëdhëni feodale mbeten si bazë e rendit shoqëror. Borgjezia, ishte shumë e dobët dhe përfaqësohej kryesisht nga borgjezia tregtare, në gjirin e së cilës nuk janë çdukur asnjëherë kontradiktat.

Nga gjiri i lëvizjes patriotike dhe përparimtare të popullit shqiptar dollën një radhë njerëzish të shquar, të cilët punuan pa u lodhur dhe pa kursyer as jetën e tyre për çlirimin e atdheut. Vëllezërit e talentuar Frashëri (Abdyli, Naimi e Samiu) ishin luftëtarë të pamposhur të kësaj lëvizjeje të madhe patriotike. Ata ja kush-

tuan të gjitha energjitet e tyre lëvizjet kombëtare të asaj kohe. Naim Frashëri — poeti kombëtar i Shqipërisë — ka shkruar shumë vepra, që i thurin lavdi atdheut, popullit dhe gjuhës amtare. Ato kanë ndihmuar në zgjimin e ndërgjegjes kombëtare dhe të ndjenjës patriotike në popull.

Botëkuptimi, ideologjia e Naimit dhe e Samiut ishin shumë afër njera tjetrës. Samiu në saje të punës së tij, të aftësive të tij të veçanta dhe të vendosmërisë u bë ideo- log i asaj etape të lëvizjes, që fillon prej vitit 1899, kur lufta çlirimtare mori karakter të hapët antifeodal dhe antiimperialist.

Me veprën e tij «Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhetë» Samiu tregoi programin e luftës çlirimtare dhe edukoi një brez të tërë me ndjenjat e besnikërisë dhe të dashurisë ndaj atdheut.

Qëllimi kryesor i patriotëve të Rilindjes ishte çliri- mi i Shqipërisë nga zgjedha turke dhe demokratizimi i vëndit.

Puna e tyre në këtë drejtim ka qenë e gjerë dhë e frytëshme, me gjithë persekutimet, që bëheshin nga ana e pushtonjësve otomanë. Përvetës kësaj pushtonjësit turq me metodën «përçë dhe suundo» përpinqeshin të ngjallnin dasitë fetare: myslimanët i quanin si turq, kurse të krish- terët si grekë. Njerëzit e shquar të Rilindjes — Naimi, Samiu e të tjerë luftuan me energji të madhe kundër përçarjeve fetare dhe treguan me bindje të plotë se besimi i vërtetë i shqiptarëve është «shqiptarizmi» dhe seasnje fe nuk duhet të prekë unitetin kombëtar të popullit.

Në lidhje me këtë, Sami Frashëri ka thënë se shqiptarët duhet të kenë vetëm një «besë për jetë a për vdekje». Ai me gjithë shpirt u bën thirje gjithë shqiptarëve që «të lënë gjaqetë e armikëritë në mes të tyre; ç'është bë- rë gjer më sot ta harrojnë, kush ka për të marë gjak ta dhuronjë».

Rilindasit ishin të mendimit se për të arrijtur qëlli- min e vetëm për gjithë shqiptarët — bashkimin, duhej të përhapej arësimi në popull. Për këtë arësy, ata kér-

konin që të krijonin shkrimin e gjuhën amtare, gjë për të cilën Samiu ka bërë një punë të madhe.

Sami Frashëri pjesën më të madhe të veprave të tij, për shumë arësy, e ka shkruar turqisht, po me gjithatë, me idetë e tij, ai ka ushtruar një ndikim të madh mbi patriotët dhe mbi masat e popullit tonë përzgjimin e ndjenjës kombëtare.

Në artikujt e gazetave dhe në librat e tij, që janë botuar në Turqi, Sami Frashëri ka bërë propagandë për Shqipërinë, për historinë e saj, dhe për virthytet e popullit shqiptar. Veprimitaria e Sami Frashërit përpërapjen e shkencave dhe të ideve përparimtare ka rëndësi të veçantë dhe e vë atë në një radhë me njerëzit përparimtarë, që kanë luftuar për ta çuar njerëzimin përparrë në rrugën e përparimit dhe të zhvillimit.

Procesi i formimit të kombit shqiptar filloj aty nga mezi i shekullit XIX. Në gjysmën e dytë të shekullit XIX pjesa dërmorjëse e borgjezisë shqiptare ishte borgjezia tregëtare, kurse borgjezia industriale përbënte përqindjen më të ulët. Midis borgjezisë shqiptare mungonte uniteti, sepse atë e ndanin kontradikta të shumta. Një pjesë e borgjezisë kërkonte kalimin në prodhimin industrial, kurse pjesa tjeter ishte përkrahëse e lirisë së pakufizuar të tregëtisë me shtetet kapitaliste. Borgjezia tregëtare ishte e lidhur me feodalët.

Në shekullin XIX rezistenca e popullit shqiptar kundër zaponjësit turk mori karakterin e lëvizjes kombëtare, gjë që frymëzohej së pari nga idetë e borgjezisë së re përparimtare dhe që përkrahej shumë nga fshatarësia e shtyrur dhe pjesërisht nga klasa feodale.

Kjo lëvizje e gjerë kombëtare që ne e quajmë «Rilindje» si qëllim të saj kryesor kishte clirim e Shqipërisë nga zgjedha turke, vendosjen e regjimit demokratiko-borg'ez në vend dhe ngritjen ekonomike e kulturale të popullit tonë.

Në vitin 1878 mbas mbarimit të luftës ruso-turke përparrë udhëheqësve të lëvizjes kombëtare u shtrua detyra që ata të formonin frontin e vetëm kundër Kongre-

sit të Berlinit, i cili nuk e njohu fare Shqipërinë si komb. Në vitin 1878 në Stamboll u krijuat Komiteti ilegal me emrin «Komiteti Qëndror për mbrojtjen e të drejtave të kombit shqiptar». Në vendet e tjera jashtë atë e quanin «Komiteti revolucionar shqiptar».

Më 13 qershor të vitit 1878 pikërisht ditën kur u mblohdh Kongresi i Berlinit, u formua Lidhja e Prizrendit. Bismarku, që ishte kryetar i Kongresit, mohoi ekzistencën e popullit shqiptar dhe ai e quajti Shqipërinë si një «shprehje gjeografike». Për të mbrojtur të drejtat e popullit shqiptar, patriotët tanë krijuan Lidhjen e Prizrendit, që u bë si Qeveri e përkohëshme shqiptare dhe që organizoi degët e saj në qytete të Shqipërisë dhe kriroi forcat e saj ushtarake.

Programi i ri i kësaj Lidhjeje, që ishte përpunuar nga Komiteti i Stambollit, u shtyp për herë të parë në formë direktivash më 27 shtator të vitit 1878 në gazeten «Terxhuman Shark» («Interpreti i Lindjes»), kryeredaktor i së cilës ishte Sami Frashëri.

Më 12 tetor të vitit 1879 u formua «Shoqëria e shtypjes së shkronjave shqipe» ose «Shoqëria e Stambollit», e cila kishte për qëllim të botonte libra, revista, e gazeta dhe të ngrinte shkolla në gjuhën shqipe. Sami Frashëri si kryetar i kësaj shoqërie lojti një rol shumë të madh. Po rolin më të madh, ai e lojti me librin e famshëm programatik, «Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhetë?», me të cilin fillon një periudhë e re e lëvizjes kombëtare.

KAPITULLI I

JETA DHE VEPRAT E SAMI FRASHËRIT

Sami Frashëri — ideologu i lëvizjes sonë kombëtare të shekullit XIX — ka jetuar dhe punuar në kushtet e perandorisë feudo-ushtarake turke.

Samiu — vëllaj i dy pionerëve të lëvizjes kombëtare — Abdylit dhe Naimit, është një nga organizatorët dhe udhëheqësit e shquar të lëvizjes patriotike dhe kulturo-lo-letrare të popullit shqiptar të fundit të shekullit XIX.

Sami Frashëri ka lindur më 5 qershor të vitit 1850 në fshatin Frashër, që gjendet në lindje të Përmetit. Mësimet e para i mori në fshat në gjuhën turqisht, arabisht dhe persisht. Gjëndja ekonomike e familjes së tij ishte e vështirë. Në vitin 1859 vdiq babaj i tij Hamiti dhe më 1861 i vdiq e ëma, Emineja.

Nën kujdesin e vëllajt të tij më të madh Abdylit ai u largua nga fshati dhe shkoi në Janinë, e cila ishte një qëndër e rëndësishme tregëtare dhe kulturale. Samiu bashkë me Naimin në fillim ndoqën kursin e gjuhës arabe dhe persiane. Më von ata hynë në gjimnazin grek të Janinës «Zosimea», që ishte një nga shkollat më të zhvilluara borgjeze në Ballkan.

Ai e mbaroi gjimnazin tetëvjeçar në vitin 1871 përshtatë vjet. Këtu ai mori kulturë të gjerë klasike, u është shumë mbas shkencave dhe mësoi mirë disa gjuhë të vjetra dhe të reja si latinisht, greqisht, turqisht, arabisht dhe persisht. Këtë gjimnaz e mbaruan edhe shqiptarë të tjera si p. sh. gjuhëtari i madh dhe patrioti shqiptar Kostandin Kristoforidhi e të tjerë.

Jeta në Janinë, revoltat e fshatarëve kundër push-tonjësve turq dhe feodalëve të mëdhenj, idetë e revolu-

cioneve borgjeze të perëndimit dhe të iluministëve, influencuan shumë në formimin e botëkuptimit demokrati-ko-borgjez të Sami Frashërit.

Samiu i ri ishte lidhur ngushtë me iluministin Nëmik Qemal, i cili në vitin 1873 vuri në skenë në Stamboll dramën e tij të parë «Atdheu» ose «Silitria». Kjo dramë që drejtohej kundër shtypësve të atdheut dhe të lirisë, ngjalli entuziazëm të madh midis rinisë.

Pikërisht në këtë kohë në moshën 23 vjeçare Sami Frashëri hyri në redaksinë e revistës «Hadika», që ishte themeluar nga Nëmik Qemali. Sami Frashëri punoi në revistë si kryeredaktor. Në atë vit ai botoi novelën e tij të parë në gjuhën turqishtë «Dashurija e Telatit dhe e Fitnetes».

Në Stamboll Sami Frashëri u lidh menjëherë me patriotët shqiptarë, me njerëzit e shquar të lëvizjes kombëtare Vaso Pashën, Jani Vreton, Ismail Qemalin e të tjera.

Drama e Nëmik Qemalit dhe gazeta «Interpreti i Lindjes», që nxirte Sami Frashëri, u ndalua nga qeveria turke, sepse flisnin kundër obsolutizmit të sulltanit. Poeti Nëmik Qemal u internua në Qipro, kurse Sami Frashëri në vitin 1874 u internua në Tripoli. Këtu gjatë atij viti punoi si redaktor në gazetën e vendit «Tripoli» dhe shkroi dramën e tij të parë «Besa». Këtë Samiu e shkroi turqisht me subjekt shqiptar, duke pasur qëllim politik që t'u tregonte turqve cilësitë e larta të popullit shqiptar. Drama «Besa» është vënë në skenë për herë të parë në vitin 1875 në Stamboll. Ajo ishte një nga veprat e para të dramaturgjisë turke, dhe e para në atë letërsi që futi fshatarët si personazhe letrare.

Sami Frashëri ishte gazetar i shquar. Ai organizoi dhe nxori gazetën e përditëshme «Sabah», që ishte gazeta e parë e përditëshme turke.

Në pranverë të vitit 1877 nga fillimi i luftës ruso-turke sultani largoi nga kryeqyteti njerëzit e dyshimtë për qeverinë turke. Kështu me urdhër të qeverisë u përzu edhe Sami Frashëri, i cili shkoi në Rodos, ku punoi si sekretar.

«Sami Frashëri — thuhet në Enciklopedinë italiane — u muar edhe me gjuhën shqipe dhe u persekutua për idetë e tij liberale». Kur u pushua nga puna ai erdhi në Shqipëri por u kthye përsëri në Stamboll prej nga, së bashku me njerëz të tjera të shquar, i dërgoi një memorandum kryetarit të delegacionit austro-hungarez pranë Kongresit të Berlinit me kërkesat e Lidhjes së Prizrendit.

Në Stamboll ai punoi si redaktor në gazeten «Interpreti i Lindjes» nën udhëheqjen e Mihranit, i cili u bë më vonë botuesi i veprave të tij. Në këtë gazetë ai botoi programin e Lidhjes së Prizrendit. Samiu ndjeu nevojën e zhvillimit të lëvizjes ideologjike dhe të zgjimit të ndërgjegjes kombëtare në masat e gjera të popullit shqiptar. Për këtë duhej, pikësëpari, të vendosej alfabeti i gjuhës shqipe, por qeveria turke nuk e lejonte një gjë të tillë. «Një nga grindjet e vazhdueshme të shqiptarëve me Turqinë — shkruan gazeta «Pravda» në vitin 1912 — ka qënë alfabeti shqiptaro-latin i vëllezërve Frashëri». Për krijimin e alfabetit, u formua një komision i veçantë. Sami Frashëri si gjuhëtar i talentuar e ndihmoi shumë atë dhe komisioni aprovoi propozimin e tij, që kishte parasysh parimin fonetik. Parimisht ai thoshte drejt se neve na duhet që alfabetin ta bëjmë sa më të lehtë për popullin. «... il faut avoir un signe pour chaque son et pour chaque son un seul signe», ka shkruar Sami Frashëri.

Samiu, si dijetar i shquar, ishte një nga inisjatorët e shoqërisë për formimin e shkronjave shqipe. Kjo shoqëri ishte një organizatë demokratike. Samiu ishte udhëheqës i shoqërisë së Stambollit dhe i degëve të saj në Shqipëri. Me gjithë kushtet e vështira nga ndjekjet turke, prapse-prapë shoqëria pati suksese të mëdha.

Në vitin 1881 u krijuar në Bukuresht dega e saj dhe në vitin 1884 filloi botimi i revistës «Drita». Sulltani, duke parë rrezikun e kësaj shoqërie, vuri censurë të fortë mbi 'të. Për këtë arësyen qendra e shoqërisë kaloi në Bukuresht, ku u botuan vepra të ndryshme shqip të Naimit dhe të Samiut, të cilat ishin shumë të nevojëshme për shkollat shqipe.

Sami Frashëri, që kishte një kulturë të gjerë, duke qenë në lidhje të ngushtë me njerëz përparimtarë, i zgjeroi edhe më tepër dijet e tij, u muar me shkencë dhe mbajti qëndrim kritik kundrejt problemeve të ndryshme e të vështira. Ai u bë një figurë e shquar në të gjithë pujt e Lindjes së Aférme.

Sami Frashëri shkroi shumë vepra: traktate politike dhe filozofike, vepra letrare e shkencore, tekste shkollore, fialorë dhe bëri mjart përkthime.

Në gjuhën shqipe ai shkroi 6 vepra, përveç një dorëshkrimi; 45 vepra i ka shkruar turqisht, arabisht dhe frëngjisht, duke mos llogaritur artikujt e shumtë që ka shkruar. Ai përktheu turqisht 6 vepra si «Histori e shkurtër e Francës», «Të mjerët» e Viktor Hugo-së dhe të tjera. Në këtë mënyrë ai shkroi gjithsejt 52 vepra dhe përktheu 6 vepra, përveç shumë artikujve dhe shkrimeve të pabotuara.

Me gjithëse veprat e shkruara shqip janë të pakta, ato kanë rëndësi të veçantë, sidomos vepra propagandistike me titull «Shqipërija ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhetë?» ku autori parashtron pikënamiet e tij politike-shqyrëre.

Në veprën me titull «Gjuha shqipe» (1879) Sami Frashëri, duke ndjekur rrugën e lëvizjes kombëtare të shekullit XIX vë në dukje rëndësinë që ka gjuha për kombin. Ai thotë: «Gjith’ ata nierëz, që gjendënë me një vent e flasinë një gjuhë, edhe që kanë një palë zakone e një sarë të rojturi thuhenë një komb... Kombetë mbahenë më gjuhetë; një komb që humbet gjuhën’ e vetë, është i humbur e i haruar, që me të humburit e gjuhës së tij është i humbur edhe ay vetë».

Vepra «Alfabetare e gjuhës shqip» është një tekst shkollor për të mësuar gjuhën shqipe. Vepra «Gramatika e gjuhës shqipe» botuar në vitin 1886 ka dhënë një kontribut të madh në përcaktimin e terminologjisë gramatikore të shqipes. Në tekstin «Dheshkronja» botuar nga shoqëria «Dituri-ja» në vitin 1888, ai pëershkroi gjeografinë e Shqipërisë. Vepra e Samiut «Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhetë?» që është shtypur për herë të parë në

Bukuresht në vitin 1899, është traktati më i rëndësishëm politik, ekonomik dhe shoqëror shqiptar i fundit të shekullit XIX. Kjo vepër kishte për qëllim të tregonte rrugën, me anën e së cilës do të mund të çlrohej sa më shpejt mëmëdheu nga zgjedha e huaj.

Sami Frashëri filloi të prebatiste fjalorin me shpjegime të gjuhës shqipe, por për fat të keq nuk arriji dot ta përfundonte. Ai ka lënë edhe një dorëshkrim me titull «Përbledhje e këngëve të vjetra dhe të reja shqipe».

Në fushën e kulturës dhe të shkencës turke dhe arabe ai dallohet si novelist dhe dramaturg, si publicist dhe filozof, si pedagog dhe linguist, si enciklopedist, si përhapës i shkencës dhe si përkthyes i veprave të rëndësishme nga literatura botërore.

Sami Frashëri e dalloi mirë pushtonjësin nga populli. Asnjë nga veprat e tij të shumta nuk i ka shërbyer pushtonjësit. Në vitin 1880 ai filloi të botojë serinë e veprave për përhapjen e dijenive shkencore (Qielli, Toka, Njeriu, Principet e kritikës, Gjuha etj.).

Veprat e para në fushën e gjuhës së turke dhe arabe fillojnë të dalin nga viti 1885. Nga këto më kryesorja është fjalori me shpjegime «Kamus Turki». Kjo vepër për herë të parë dolli në vitin 1901.

Në vitin 1889 ai batoi vëllimin e parë të Kamus-ul-alamit, që është një nga veprat më të rëndësishme turke të shekullit XIX.

Vepra «Kamus-ul-alam» (fjalor biografik-geografik) është në 6 vëllime. Vëllimi i fundit është botuar në vitin 1899.

Përveç veprave të botuara thuhet se Šamiu ka lënë edhe shumë dorëshkrime, studime letrare, kulturale dhe shkencore, të cilat nuk arriji t'i batojë.

Njerëzit përparimtarë të Shqipërisë dhe të Turqisë e çmuant shumë këtë njeri të shquar. Shkrimtari iluminist turk Ahmed Ihsan në artikullin nekrologjik të titulluar «Një humbje e vajtueshme», e ka quajtur Sami Frashërin «mjeshtër të madh» dhe ka shkruar kështu: «Sami Frashëri është i vetmi shkrimtar, po, është e vërtetë, i

vetëm ndër shkrimtarët otomanë, veprat shkencore të të cilët na habisin të gjithëve...»

Iluministi Sami Frashëri si të gjithë patriotët, megjithëse ndodhej në gojë të ujkut, punoi pa u lodhur për shpëtimin e kombit të tij. Pjesëmarrja aktive e Samiut në lëvizjen kombëtare, pikëpamjet e tij demokratike dhe përparimtare kundër absolutizmit të sulltanit, nuk i pëlqenin qeverisë turke. Prej vitit 1890 ai ndiqej nga spiu-nët e sultananit. Pas botimit të librit «Shqipëria ç'ka që-në, ç'është e ç'do të bëhetë?», ai u ndalua të dilte nga shtëpia, ku ishte si i burgosur.

Në këto kushte të vështira të jetës, nga sëmundja dhe nga puna intensive më 18 qershori të vitit 1904 Sami Frashëri vdiq në tavolinën e punës.

KAPITULLI II

PIKËPAMJET FILOZOFIKE TË SAMI FRASHËRIT

Sami Frashëri, që është ideologu më i madh i lëvizjes kombëtare të popullit shqiptar në gjysmën e dytë të shekullit XIX, u muar dhe me çështje filozofike. E vërteta është se çështjet e teorisë së të njohurit zënë relativisht një vend të vogël në trashëgimin filozofik të Sami Frashërit, i cili i kushtoi më shumë energji përpunimit të problemeve shoqërore politike, si dhe çështjeve të gjuhësisë dhe përhapjes së njohurive shkencore në masat e popullit.

Ai nuk ka studime të veçanta për çështje filozofike, por me gjithë këtë koncepti filozofik që kishte Samiu del qartë nëpërmjet veprave të tij. Në serinë e librave, që morën emrin «Biblioteka e xhepit» Sami Frashëri i dha masës së lexonjësve njohuri të ndryshme mbi botën, që e rrethon: për kozmosin, për natyrën, për njeriun dhe për fenomenet shoqërore. Ai shkroi më tepër se 20 libra, në të cilat jo vetëm që ka paraqitur në mënyrë të thjeshtë njohuritë shkencore për masat popullore të Perandorisë turke, por se në to ka formuluar edhe pikëpamjet e tij mbi çështie të ndryshme filozofike.

Në librat «Qielli» dhe «Toka» ai jep shpjegimin shkencor mbi ndërtimin e gjithësisë dhe të planetit tonë. Duke u nisur nga të dhëna shkencore të kozmogonisë, ai godit pikëpamjen fetare mbi krijimin e botës. Njëkohësisht ai kritikon ashpër bestytnitë, duke i konsideruar ato si burim të padi's në çështjet shkencore.

Në librin «Njeriu» ai hedh poshtë legjendën biblike mbi Adamin dhe solidarizohet me pikëpamjen evolucioniste të Daryinit. Veprimitaria e Sami Frashërit nuk u kufizua thjesht me propagandimin e njohurive shkenco-

re, por ai si patriot i flaktë dhe si demokrat revolucionar luftoi kundër zgjedhës turke dhe kundër absolutizmit të sulltanit. Kjo veprimtari patriotike e demokratike përcakton edhe gjithë botëkuptimin e tij. Sami Frashëri si ideo-logu kryesor i lëvizjes sonë kombëtare i kishte vënë vetes si qëllim çlirimin e Shqipërisë nga zgjedha turke, luftën kundër rendit feodal ushtarak dhe kundër botëkuptimit mistiko-fetar të Perandorisë turke.

Veçoritë kryesore të botëkuptimit të Sami Frashërit

Duke studiuar veprat e Sami Frashërit del se ai kishte njohuri përrrymat e ndryshme filozofike, përmaterializmin naiv të Greqisë së Vjetër dhe e cmoi shumë Aristotelin, të cilin e quajti «si më të madhin e filosofeve të Greqisë së vjetër». Samiu cmoi shumë gjithashtu Ibni Sinen, materialistët dhe iluministët francezë të shekullit XVIII si dhe doktrinën e Darvinit, përtë cilën ushqente një simpati të madhe.

Për veprat e tij ai u mbështet në filozofinë e përparruar dhe në sukseset e shkencave të asaj kohe. Sami Frashëri studioi shkencat e natyrës dhe kishte besim të madh në fuqinë njohëse të shkencës.

Ai mbroi deri në fund traditat më të mira kulturale dhe shkencore të të gjithë popujve dhe kishte bindje të plotë në zhvillimin e vazhdueshëm të qytetërimit.

«Nuk jemi nga ata — shkruan ai — që e mohojmë fuqinë e rëndësinë e qytetërimit të Greqisë së vjetër. As nuk pretendojmë se nuk i kanë shërbyer zgjimit t'Euro-pës mësimet e veprave greke, që u dhanë nga mësonjësit, që erdhën në Itali nga Bizanti. Por nuk na bëhet të besojmë se lëmshi i dheut mbeti i zbrazët prej qytetërimit qysh prej ditës që u shua qytetërimi i vjetër grek e deri sa lindi qytetërimi evropian, se u zhyt në terrin e injorancës dhe të egërsisë dhe se qytetërimi i sotëm evropian është vepra e disa shkencëtarëve bizantinë, që ikën nga Bizanti...



Vllezërit Frashëri

31569

Gjithmonë një qytetërim më i vonshëm është më i përsosur se qytetërimi i mëparshëm».

Samiu në kundërshtim me konceptin metafizik i shikoi ndryshimet kualitative të zhvillimit të shoqërisë nga një formacion në tjetrin. Ai i kritikon ata njerëz që mo-hojnë zhvillimin historik të shoqërisë. Dimë se shkenca historike marksiste-leniniste e konsideron procesin historik si një ndrim të ligjshëm të formacioneve ekonomike-shoqërore.

Sami Frashëri ngre rolin e madh të kulturës mesjetare mbas qytetërimit grek. Ai përmend veprat e shumë dijetarëve dhe filozofëve arabë dhe rolin që kanë luajtur ata në zhvillimin e qytetërimit evropian.

Dihet se historia e kulturës mesjetare flet për shum shkrimitarë dhe piktorë, shkencëtarë, filozofë dhe publicistë të shquar, veprimitaria e të cilëve kishte karakter të thellë përparimtar dhe ka luajtur një rol të madh në zhvillimin kultural të njerëzisë.

Samiu kishte të drejtë që thoshte se koha midis qytetërimit të vjetër grek dhe qytetërimit të sotëm evropian nuk mbeti e zbrazët, sikundër mendonin disa. Në këtë periudhë, me gjithë prapambetjen e filozofisë në shoqërinë feodale, e cila u bë shërbëtore e fesë prapëprapë tendenca materialiste e filozofisë, që persekuhej me egërsi, nuk u zhduk, por qëndroi dhe u zhvillua. Tendençat materialiste vazhduan të qëndrojnë gjatë gjithë kohës së mesme, veçanërisht në vendet e Lindjes.

Dihet se borgjezia, që kërkonte zhvillimin e forcave prodhuase, përkrahte dhe interesohej për përvetësimin e shkencës, me anë të së cilës të zbulonte ligjet e natyrës. Sami Frashëri si përfaqësues i borgjezisë së re dhe inteligjencës përparinitare të asaj kohe në shoqërinë shqiptare dhe turke, foli për çlirimin e shkencës dhe të filozofisë nga prangat e fesë mesjetare dhe nga skolastika. Botëkuptimi i tij pasqyroj ndryshimet e thella politike dhe shoqërore-ekonomike, që lidheshin me lëvizjen kombëtare në Shqipëri dhe me kalimin nga feudalizmi në një rend shoqëror republikan, që t'i conte përpara forcave prodhuase.

23672

Demokrati dhe mendimtari përparimtar shqiptar Sami Frashëri u përpoq vazhdimisht të lidhë çështjet teorike me detyrat praktike të luftës kombëtare të popullit shqiptar dhe me përmirësimin e gjëndjes ekonomike të Shqipërisë.

«Shërbimi — shkruan Samiu — që mund t'i bëhet një të varfëri nuk është për të lehtesar jetën e tij, por për t'i treguar rrugën se si të shpëtojë nga varfëria.»

Hegeli dhe idealistë të tjera supozuan se realiteti në fund të fundit është vetë i arsyeshëm, prandaj duhet pajtuar me 'të. Hegeli ishte i mëndjes se monarkia konstitucionale ishte kulmi i progresit shoqëror.

N. G. Çernishevski duke kritikuar drejt Hegelin për «indulgjencë të dhembëshme ndaj ekzistueses», nën-vizoi se Hegeli është «rrob i gjëndjes së tanishme të sendeve, të ndërtimit të tanishëm të shoqërisë».

Sami Frashëri, duke analizuar zhvillimin e mendimit në Lindje, thotë se në mes të filozofëve u bë një luftë e ashpër ideologjike. Ai thotë se «në këtë luftë nga këto përleshje mendimesh lindën natyralistët, materjalistët, shismatikët, mistikët e theologët. Filozofët si *Spinoza* e *Hegeli* të cilët në Evropë njihen si filozofë mistikë mund të konsiderohen si dishepujt e mistikëve islamë». Samiu e konsideroi Hegelin si «një ndër filozofët e famshëm të Gjermanisë». Është e rëndësishme se Samiu siç duket qysh në vitin 1886 ishte në korent të diskutimeve filozofike, që nxirnin në dritë anën mistike të dialektikës së Hegelit. Sigurisht që ai nuk mund të zbulonte dhe të nxirrte në dritë dobësitë dhe anët negative të sistemit të Hegelit, por qëndrimi i tij deri diku negativ karshi idealizmit objektiv të Hegelit ka rëndësi të vëçantë dhe është një anë pozitive. Filozofia e Hegelit dihet se ka qenë mjart e përhapur dhe dominonte në Evropë. Vetëm Marks i Engelsi në shekullin XIX bënë kthesën e madhe në filozofi, e cila u bë një armë e fuqishme e proletariatit në luftë për përbysjen e sistemit kapitalist.

Dihet se teoritë politike dhe në përgjithësi të gjitha doktrinat filozofike gjithmonë janë formuar nën influen-

cën e fortë të atij rendi shoqëror, të cilit i përkisnin, dhe çdo filozof përfaqësonë një parti politike.

Sami Frashëri i shkoi afër kuptimit të kësaj çështjeje që ishte në diskutim midis materialistëve dhe idealistëve. E vërteta është se ai nuk e analizon me hollësi këtë problem, por tek Samiu gjejmë disa thënie interesante.

Kështu, p. sh., ai në fjalët e urta filozofike «Emsal» thotë:

«Është e pamundur të — idetë (d.m.th. pikëpamjet filozofike dhe politiko-shoqërore — E. R.) nga interesë». «Kurkush — vazhdon të thotë më poshtë Samiu — nuk i shërben një ideje, që është në kundërshtim me interesat e tija».

Gjithashtu Sami Frashëri ishte mbrojtës dhe përkrahës i lirisë së mendimit dhe të fjalës. Ai ishte kundër shtypjes dhe tiranisë. «Tiranija më e tmerrshme — thotë ai — është ajo që ushtrohet mbi idetë».

Më poshtë, duke shprehur urrejtjen kundër ndrydhjes së mendimeve të lira, ai thotë:

«Shtypja e idesë është gjaku, që derdh tiranija».

Mendimi tari Sami Frashëri ishte patriot i flaktë dhe mbronte interesat e larta të popullit të vet.

«Trim — ka shkruar Samiu — është ai, që vdes për të ruajtur nderën e tij kombëtare ose për të mirën e njerëzisë».

Tiparet materialiste në botëkuptimin e Sami Frashërit.

Sami Frashëri, Jani Vreto dhe njerëz të tjera përparimtarë të Shqipërisë në gjysmën e dytë të shekullit XIX, kujdesin dhe punën më të madhe ja kushtuan lëvizjes kombëtare të popullit, kundër sundimit turk dhe kundër despotizmit të sulltanit. Por ata u muarën edhe me probleme teorike, e pjesërisht edhe me probleme filozofike. Ideologët e lëvizjes kombëtare, përveç unititetit në pikëpamjet filozofike, deri në një farë shkalle kishin unitet edhe në çështjet filozofike.

Zhvillimin e mendimit në Shqipëri e ka penguar shumë pushtimi turk. Prandaj në analizën e botëkup-timit të Sami Frashërit duhet gjithmonë të kemi parasysh kushtet konkrete historike, në të cilat jetoi dhe punoi ai.

K.Marks, duke folur për gjëndjen e Turqisë së sulltanit shkruan se ajo gjëndesh «në stadën më të ulët dhe më barbare të feodalizmit»

Dihet se të gjitha doktrinat dhe shkollat e ndryshme filozofike u muarën me zgjidhjen e problemit themelor të filozofisë — raporti i ndërgjegës me qënien.

Materialistët, duke u mbështetur në të dhënrat e shkencës dhe të praktikës njerëzore, pohojnë se prima-re është natyra, kurse ndërgjegja është sekondare d.m.th. pasqyrimi i materjes, i qënies.

«Materja — shkruan K. Marks — nuk është produkt i shpirtit, ndërsa vetë shpirti s'është gjë tjetër veç se produkt i lartë i materjes».

Idealistët, në kundërshtim me materialistët, konsiderojnë parimare ndërgjegjen, kurse sekondare natyrën, materjen. Kështu që problemi i unititetit të botës është i lidhur ngushtë me çështjen themelore të filozofisë.

Sami Frashëri, duke u bazuar në të dhënrat e shkençës së asaj kohe, ka dhënë kontributin e tij në kuptimin e drejtë të zhvillimit historik të natyrës dhe të shoqërisë. Sigurisht që tek ai nuk ka dhe as që pretendohet të ketë në unitet, konsekuençë dhe kontinuitet integral në tërësinë e mendimeve të tij. Kjo është e llogjikëshe me dhe vjen sepse, me gjithë se ai ishte nën influencën e ideve të përparuara, prapëseprapë nuk u shkëput dot krejt nga ambienti ku jetonte. Tek Samiu kanë influençuar shumë materialistët vulgarë të Greqisë së vjetër, materialistët e Lindjes dhe materialistët francezë të shekullit XVIII. Për shpjegimin e ndërtimit dhe të zhvillimit të gjithësisë ai mbështetet në suskeset e degëve të ndryshme të shkencës.

Pikëpamjet kozmogonike, që propagandonte Sami Frashëri, jo vetëm që i dhanë goditje të forta legjendës theologjike mbi krijimin e botës, por njëkohësisht bash-

kë me këtë përfaqësonin një nga përpjekjet e tij për të kuptuar botën në zhvillimin e saj.

Samiu është përkrahës i materializmit spontan, që mbështetet në shkencat e natyrës. Ai, duke u nisur nga të dhënat e shkencave të natyrës, arriji në disa konkluzione materialiste.

Sami Frashëri pohon se burimi fillestare është *materja*, të cilën ai e quan *eter*.

«Substanca e gjithësisë — shkruan Samiu — është eteri (materja, E. R.). Nga kjo materje kanë lind ır botërat dhe prej kësaj kuptohet se dikur gjithësija ishte e përbërë prej materjes dhe kjo hapësirë e pakufizuar, që e thërasim quell, ishte e mbushur vetëm me eter».

Samiu, duke u nisur nga të dhënat e fizikës, të këmisë dhe të astronomisë bën konkluzione të rëndësishme filozofike, që i afrohen materializmit. Ai niset nga fakti se «eteri është lëndë materiale». Nga kjo rrjedh edhe mendimi i tij mbi botën materiale.

Për t'u bindur që kuptimi i termit të eterit është i njëllojtë me atë të materjes, po sjellim këtë thënie të tij:

«Fuqia e tërheqjes është dhe në eter, pse edhe ky është një trup. Kështu që dhe atomet e eterit qëndrojnë të bashkuara në sajë të bashkimit të këtyre dy fuqive d.m.th. të forcës tërheqëse dhe shtytëse.»

Sami Frashëri, duke u mbështetur në sukseset e shkencave, i dha një grusht të fortë idealizmit e fesë dhe dërmoi ideologjinë e monarkisë absolute.

Zbulimet shkencore të bëra nga Galileu dhe nga Kepleri ai i konsideroi si fillimin e një epoke të re në rrugën e zbulimeve qellore. Ai shkruan për njerëzit e dëgjuar të shkencës me admirim dhe me simpati.

«Dy shekuj më parë — shkruan Samiu — erdhën në Itali Galileu dhe në Gjermani Kepleri, të cilët provuan se toka me trupat e tjerë qellore lëviz rrëth Diellit. Dhe që nga ajo ditë u hap një udhë e re dhe e gjerë për zbulime qellore. Më pas duke përparuar shkenca e matematikës e shkencat e natyrës, dijetarët si Njutoni, Hersheli, Shnaideri, Kanti, etj. me teleskopa në dorë ndriçuan men-

djen e njeriut, duke zbuluar sa e sa të vërteta, sikur ata të kishin udhëtar në qill nga një yll në tjetrin».

Sami Frashëri, duke u bazuar në teorinë heliocentrike të ndërtimit të gjithësisë, i dha një grusht të fortë botëkupimit fetar të kohës, sipas të cilët bota është e përbërë gjoja nga dy pjesë të kundërtat: Toka e mëkateve dhe qielli fisnik.

Sami Frashëri e vuri tokën në radhën e planeteve dhe tregoi se ajo së bashku me këto trupa qiellore (planete) rrrotullohet rrreth Diellit. Kështu Samiu në kundërshtim me paragjykimet fetare të asaj kohe në Turqi e konsideroi Tokën si një trup qiellor — dhe si një nga format e ndryshme të materjes unike, të përjetëshme dhe të pa-fundtë.

Sipas përfytyrimeve fetare-mistike qielli ishte vendbanimi i perëndive dhe i ëngjëjve. Sami Frashëri i hodhi poshtë këto përfytyrime prapanike reaksionare dhe duke u mbështetur në zbulimet astronomike u tregoi mësime të popullit perspektivat e gjera të shkencës astronomike.

«Ato re të vogla (nebuloza) — shkruan ai — janë sej-cila një botë më vehte. Në sejcilën prej tyre ka miliona diellra, e çdo diell ka një shumicë satelitësh e në sejcilin satelit *ka krijesa të gjalla të panumurta*. Secila prej tyre është e madhe, sa bota e jonë, ndoshta edhe më e madhe».

Galileu kish treguar qysh prej kohësh se trupat qiellore nuk i përkasin ndonjë bote tjetër të veçantë qiellore, por janë trupa sikurse Toka. Sami Frashëri duke u bazuar në të dhënat e shkencave demaskoi gjithashtu thënjet fetare, sipas të cilave qielli ndryshon krejt nga Toka dhe se trupat nuk janë një lloj në gjithë botën.

Në kundërshtim me idealistët, të cilët si substancë të botës konsideronin idenë mistike absolute, shviritin botëror, ndërgjegjen, Sami Frashëri thotë se pikërisht materja (eteri) është baza e vetme, thelbi, substanca e të gjithë gjërat dhe sendeve.

Sami Frashëri pranon unitetin dhe pluritetin e botës, që na rrrethon. Për shpjegimin e ndërtimit të sistemit diellor dhe të planeteve të tij ai mbështetet në të dhënat

e shkencave përkatëse dhe pranon zhvillimin e përgjithshëm të rregullt dhe transformimin e trupave të panumërt qiellore të gjithësisë.

Ja si ka shkruar Samiu:

«Të gjitha këto trupa, që kanë mbaruar formimin e proçesit të tyre, ose që janë në formim e sipër, ose që porsa e kanë filluar proçesin e formimit, kanë lindur nga një substance origjnale dhe janë formuar sipas një metode dhe rregulli të përgjithshëm».

Sami Frashëri, duke u bazuar në hipotezat kozmogonike të Kantit dhe të Laplasit, të cilat janë një etapë e rëndësishme në rrugën e njoftes së unitetit material të botës, së përjetësisë dhe të pafundësisë së saj, ishte përkrahës i idësë së zhvillimit të sistemit diellor nga masa e parë e rallë e materjes nën veprimin e forcave të brëndëshme të atrakcionit dhe të forcës shtytëse. Kjo demaskon përrallën fetare mbi krijimin e botës nga një fuqi e jashtme.

Sami Frashëri e shikon burimin e lëvizjes në vetë brendinë e materjes; lëvizja rrjedh nga forca tërheqëse dhe nga forca shtytëse.

«Jeta e botës — shkruan Samiu — parimi sh mbështetet në një fuqi dhe në një rregull të madh, të cilat janë fuqija tërheqëse dhe shtytëse dhe nga këto fuqi bazë lindin lëvizja, ngrohtësija dhe drita».

Sami Frashëri, duke u nisur nga sukseset e kimisë, iu afrua kuptimit të multitetit (shumëlojshmërisë) të pafund të proçeseve materiale, lidhjes reciproke dhe transformimit të tyre nga njera formë në tjetrën.

«Një element i ngurtë — shkruan ai — mund të transformohet në të lëngshëm ose në gaz; gjithashtu një element në gjëndje gazi mund të kalojë në gjëndje të lëngët ose të ngurtë».

Sami Frashëri tregoi se në bazën e gjithë këtyre transformimeve është materja unike.

Më von shkenca me ndihmën e analizës spektrale caktoi përbërjen e njëllojtë kimike të trupave qiellore dhe të Tokës.

Çështjen e unitetit material dhe të multitetit të fenomeneve, e zgjidhi shkencërisht vetëm filozofia marksiste

te-leniniste e cila na mëson se në të gjitha fenomenet e realitetit ndodhen si të përgjithshmet ashtu dhe veçantitë specifike dhe individuale; sepse e përgjithshmja ekziston dhe duket jo pranë të pjesëshmes, të veçantës, por vetëm në 'të dhe nëpërmjet saj.

Sami Frashëri e shikon botën si të pafundme e të pakufishme.

«Qielli — shkruan Samiu — është një hapësirë pakufi, që përbledh të gjitha krijesat, të gjithë botërat dhe të gjitha trupat qiellore, të cilët nuk është e mundur të përcaktohen me shifrat që dimë ne». Këtë botë, pa mbarim, pa anë dhe pa kufi, ai e shikon në lëvizje të vazhdueshme e të pandërprerë.

«Bota — shkruan ai — është nië oqean eteri pa mbarim, pa anë e përherë në lëvizje».

Sami Frashëri në fakt njeh ekzistencën objektive të hapësirës dhe të kohës.

«Nuk mund të themi — thotë ai — se gjithë këta trupa kanë një anë dhe një kufi»..

Më poshtë thotë se «ajo, hapësira qiellore pa anë dhe pa mbarim është eteri».

Samiu flet se për fillimin dhe mbarimin e botës ka shumë debate dhe se njerëzit kanë frikë të merren me të tilla diskutime. «Kur ka filluar bota? Kur do të mbaroë?... Këto pyetje e bëjnë të komplikuar çështjen dhe njerëzit kanë frikë se mos bijen në afetari... Unë nuk e kam frikë afetarinë — thotë ai».

Sami Frashëri ngre dhe analizon çështjen e boshllëkut. Ai pohon se boshllëku është relativ, sepse në realitet sipas të dhënave të shkencave boshllëk nuk ekziston.

«Në botë — thotë ai — nuk ka bosh kurrgjë».

Ai ka qenë përkrahës i filozofisë atomiste.

«Të gjitha trupat, që ndodhen në botë — thotë ai — janë të përbëra prej thërmiiash shumë të vogla, që quhen atome (turqisht «zerre»)».

Ai flet me simpati për materialistët e vietër grekë dhe materialistët francezë — përkrahës të teorisë atomiste.

«Dideroi — shkruan Samiu është filozof i shqar francez. Dëshira e tij ishte të merej me shkencë dhe kësh-

tu u dha pas leteraturës, filozofisë e gjeometrisë. Për të fituar bukën shkroi e botoi libra, ndër të cilat më e para ishte «Vlera e virtutit», botoi dhe disa apoftegema, por këto u mblohdhën dhe u dogjën me vendim të parlamentit... Dideroj është armik i madh i kristianizmit dhe sidomos kundër klerit. Ai ishte ateist».

Për Holbakun shkruan kështu.

«Materialist i famshëm... shkroi kundra kristianizmës dhe shumë vepra të tjera mbi moralin e përgjithshëm. Vepra e tij më e përmëndur është ajo, që mban emrin «Système de la nature» («Sistema e natyrës»), të cilën materialistët e konsiderojnë si një vepër të rëndësishme».

Në përcaktimin e materjes Sami Frashëri i afrohet shumë Didërojt, duke e përcaktuar materjen si substancë unike, kurse trupat si forma të ndryshme të qënies së kësaj substance unike.

«Substanca e vetme e gjithësisë — thotë Samiu — është eteri (materja E. R.) dhe se nga ky kanë lindur botërat dhe trupat».

Dihet se, prej kohësh përpara, Helvetiusi eviton përcaktimin e materjes si substancë, duke thënë se si e tillë materja «në përgjithësi» nuk ekziston.

Zhvillimi historik i botës

Në shekullin XIX përpara shkencave të natyrës shtrohej problemi se në ç'mënyrë ka arrijtur në gjëndjen e sotme të përsosur bota organike dhe inorganike.

A ka qenë natyra gjithmonë kështu?

Mendimet mbi zhvillimin e natyrës, të çfaqura në shekullin XVIII nga materialistët francezë kanë hasur rezistencë të madhe nga të gjitha forcat e reaksionit. Dihet se natyralistët rusë — Djadkovskij e të tjerë — kanë mbrojtur me guxim idenë e zhvillimit të natyrës.

Sami Frashëri këtë çështje të rëndësishme filozofike e shpjegoi drejt në mënyrë shkencore. Ai me bindje të plotë dhe me vendosmëri, në kundërshtim me pikëpa-

jen fetare, mbroi kuptimin materialist mbi zhvillimin historik të natyrës, duke u mbështetur mbi të dhënët e shkencave të natyrës, sidomos mbi doktrinën evolucioniste të Darvinit.

«Bota — shkruan ai — nuk është krijuar menjëherë, po gradualisht dhe bille provohet shkencërisht se disa botëra edhe sot janë në krijimin e sipër, kurse disa botëra ose së paku disa trupa sot janë çdukur». Kjo thënje e Sami Frashërit ka një rëndësi të madhe për sanksionimin e kuptimit materialist të zhvillimit historik të natyrës përkundrejt opinionit që sundonte në Turqinë monarkiste-fetare të prapambetur të asaj kohe. Kjo tregon gjithashtu se Samiu si erudit ishte në korent të zbulimeve të reja të shkencave të natyrës.

Sami Frashëri, duke u mbështetur në doktrinën e Darvinit, tregoi se llojet e ndryshme të botës organike — bimët, kafshët dhe njeriu janë rezultat i zhvillimit natyral historik, që ka vazhduar miliona e miliona vjet. Samiu kishte shumë simpati për bashkëkohësin e tij — Darwinin, i cili sipas thënjes së V. I. Leninit «i dha fund pikëpamjes se gjoja llojet e kafshëve dhe të bimëve nuk janë të lidhura me asgjë dhe janë të rastit e «gjoja të krijuara nga zoti» dhe të pandryshueshme».

Samiu ishte partizan i Darvinit, për të cilin, në fjalorin historiko-gjeografik Kamusu Alam ka shkruar kështu:

«Kishte njoħuri dhe eksperiencë të gjerë në ligjet e natyrës dhe ishte i pajisur me një inteligjencë të jashtezakonëshme. E kaloi jetën duke u marë me studime dhe kërkime shkencore dhe hyri në radhën e shkencëtarëve të mëdhenj, duke pasur një ide thjesht origjinale të tij-në... mejtimet e tij bazoheshin në prova të qarta e bindëse. Sot ajo teori që thiret Darwinizëm është pranuar si një realitet shkencor nga të gjithë natyralistët. Darvini është marrë kryesisht me ndryshimet dhe ngjasimet e llojeve të ndryshme të kafshëve e të bimëve, duke studjuar shkakun e këtyre ndryshimeve dhe mënyrën se si janë bërë këto ndryshime. Disa natyralistë në Francë e në vendet e tjera të Evropës kanë qfaqur disa mendime të shpërndara, por Darvini është ai që e futi këtë stu-

dim në një formë shkence, duke dhënë prova bindëse dhe duke zbuluar ligjet shkencore. Prandaj kjo shkencë mori emrin Darwinizëm. Ai botoi në këtë lëmë një shumicë veprash, të cilat u përkthyen në gjuhë të ndryshme evropiane, kështu që emri i tij u bë i njohur në gjithë botën. Por shumica e njerëzve nuk e kuptuan mendimin e tij dhe udhën e ndjekur nga ai; kështu duke mos i njohur mendimet dhe metodat e punës së tij, u përpoqën ta paradesin si një person të urejtur, pse ai kishte përkrahur atë teori, që ata e quanin të gabuar sipas së cilës njeriu e ka origjinën nga majmuni...»

Doktrina e Darvinit i dha një grusht të fortë fesë, prandaj kisha i bëri një luftë të ashpër atij dhe u mundua ta hedhë poshtë. «Akademia e shkencave në Francë — shkruan Samiu — me shumë vështirësi mundi ta **pranojë si anëtar nderi të Akademisë** dhe për këtë shkak ajo u **sulmuar rreptësisht nga shtypi katolik**.

Sami Frashëri duke u mbështetur në doktrinën e Darvinit, tregoi se njeriu ka ardhur nga bota e kafshëve dhe se nuk është krijuar nga zoti në «formë të gatëshme», por se është rezultati i një procesi të gjatë evolucionar. Kështu këtë çështje ai e vendosi në mënyrë dialektike, duke u nisur nga të dhënat e shkencës së natyrës.

Sami Frashëri luftoi kundër teizmit që thotë se zoti përzihet në jetën e përditëshme të njerëzve dhe drejton veprimtarinë e tyre. Në këtë kohë në Turqi sulltani ishte përfaqësues i shtetit dhe nëkohësisht i zotit. Në këtë mënyrë pikëpamjet e Sami Frashërit ishin një goditje e fortë kundër teokratizmit si dhe kundër fesë.

Sami Frashëri mbi origjinën e njeriut

Prej shumë kohe përparrë është ngritur çështja: Nga ka ardhur njeriu? Në shkallët e ndryshme të zhvillimit të shoqërisë njerëzit kanë dhënë përgjigje të ndryshme për këtë çështje.

Sami Frashëri ka shkruar një libër të veçantë mbi njeriun dhe mbron doktrinën e Darvinit mbi zhvillimin

gradual të kafshëve dhe të bimëve nga shkalla më e ulët në më të lartën. Duke u mbështetur në doktrinën e Darwinit mbi origjinën e njeriut, ai tregoi evolucionin e zhvillimit të njeriut dhe të shoqërisë në periudha të ndryshme historike. Ai në kundërshtim me fantazitë fetare përkrijimin e kafshëve dhe të bimëve, me bindjë të plotë tregoi se njeriu në zhvillimin e tij ka kaluar një evolucion të komplikuar nga mbretëritë e kafshëve deri në shoqërinë e sotme.

«Nuk mund të pretendohet — shkruan Sami Frashëri — se njeriu vetëvetiu është i qytetëruar ose është krijuar i tillë. Njeriu është krijuar pothuajse në të njëjtën gjëndje egërsore me kafshët e tjera».

Sami Frashëri pranon se stërgjyshi i njeriut ishte një lloj majmuni i zhvilluar. Ai shkruan se në Amerikën e Veriut shkencëtarët kanë gjetur kocka të vjetra, të cilat janë kocka të njeriut. «Kështu që mund të gjykojmë se në ato periudha ka jetuar një lloj kafshe në mes të majmunit e njeriut ose një majmun që ka qenë më afër njeriut se majmunët e sotëm. Nuk e dijmë se kësaj kafshe a mundet t'i jepet emri njeri; por sidoqoftë kjo krijesë shënon fillesën e dukjes së njeriut mbi sipërfaqen e kësaj toke».

Njeriu, thotë Samiu, i është nënshtuar një procesi të gjatë zhvillimi. Ai bën dallimin e njeriut nga kafsha dhe është kundër kuptimit të materializmit mekanik fë shekullit XVIII, i cili njerinë e konsideronte si kafshë.

«Njeriu — shkruan ai — është i pajisur me cilësira të larta, me tru e me arësy. Ai nuk hyn në radhë të kafshës së unjët dhe me gjithëse i vogël nga trupi, rëndësia e tij është më e madhe se toka, cielli dhe se çdo krijesë tjetër».

Sami Frashëri nuk është në një mëndje as me pikëpamjen e materializmit mekanik as edhe me atë të mistikëve.

«Në këtë traktat — shkruan ai — nuk do t'i nënshtrohem i as mendimit të atij materializmit që e konsideron njeriun gati të njëllojtë me shtazët ose që e numëron atë si bimë që i ka rrënjet në zemër,

gjithashtu nuk do t'i japim aq rëndësi të madhe njeriut duke pranuar plotësish besimin e mistikëve. Ne kemi qëllim jo të meremi me poezi e me imajjinatë, por t'i caktojmë njeriut vendin që meriton. Atyre që duan ta rritin tepër njeriun do t'u tregojmë vogëlsinë dhe të metat e tij dhe atyre aë duan t'ja ulin fare vlerën do t'u provojmë se ai është një qenie e përsosur».

Dihet se para marksizmit asnjeri, bile as Darvini, nuk mundi të shpiegojë brendinë sociale të procesit të zhvillimit të njeriut. Vetëm F. Engelsi, duke u mbështetur gjithashtu në doktrinën e Darvinit mbi origjinën e njeriut, tregoi se në procesin e transformimit të majmunit në njeri rolin kryesor e ka luajtur *puna*.

Engelsi ka shkruar: «Puna ka krijuar vetë njeriun».

F. Engelsi shpjegoi origjinën e atyre veçorive kryesore, të cilat e dallojnë njeriun nga kafshët si dha nga majmunët: natyra sociale e njeriut, truri i zhvilluar në shkallë të lartë, të folurit e artikulluar etj.

Sami Frashëri tregoi se njeriu dallohet nga kafshët nga të folurit dhe nga të menduarit.

«Njeriu — shruan ai — nga një vështrim është n'ëlloj me ato mijra kafshësh, që jetojnë mbi tokë, por që dallohet prej tyre nga të folurit dhe nga mendimi».

Për rrëthanat konkrete në të cilat jetonte Samiu, këto janë mendime përparimtare dhe një hap i mëh përrpara në ambientin e prapambetur turk. Më gjithë këtë Sami Frashëri nuk mundi të shkojë më tutje në l'dhje me zhvillimin e njeriut, por kaloi në deizëm. Ai, duke treguar se njeriu u pajis nga një fuqi e mbinatyreshme me «arësyen» dhe me «mëndjen», nuk kuptoi natvrën shogërore të njeriut dhe rolin e punës, që krijoit vetë njerinë. Samiu, duke mos qenë krejt i shkëputur nga influenca e fesë, në kuptimin e drejtë të njeriut bie në pozita eklektike dhe kërkon të gjejë një rrugë të mesme, duke deklaruar se njeriu është sinteza e një trupi dhe e një shpirti.

Por sidoqoftë ai kuptoi një nga veçoritë kryesore që e dallon njeriun nga kafshët.

«Është fuqia mendore — shkruan Samiu — që e dallon njeriun nga kafshët».

Por ai nuk ariu dot të analizojë gjithë procesin shumë të gjatë dhe të ndërlikuar të shndrimit gradual të trurit të majmunit në tru të njeriut. «Në fillim — thotë F. Engelsi — puna, dhe pastaj bashkë me të edhe gjuha e artikulluar, kanë qenë dy faktorët më kryesorë nën influencën e të cilëve truri i majmunit u shndrua dalëngadalë në tru njeriu...»

Samiu duke mos qenë në gjëndje të shpjegojë se si u bë ndarja e njeriut nga mbretëria e kafshëve, i drejtohet fuqisë së mbinatyrrëshme — zotit, i cili simbas tij e paisi gjoja me mëndje dhe me mjete për të përmirësuar veten e tij.

«Njeriu — ka shkruar Samiu — është krijuar pothuaj se në të njëjtën gjëndje egërsore me kafshët e tjera, veçse i plotëfuqishmi zot i dha një fuqi e një prirje njeriut për të përmirësuar veten dhe për t'u qytetëruar».

Sami Frashëri si deist njihte një fuqi të mbinatyrrëshme, por këtë ai e largoi nga procesi shoqëror i zhvillimit të shoqërisë, dhe si forcë lëvizëse të shoqërisë ai quajti «mendimin» dhe «arësyen». Duke u nisur nga kjo pikëpamje ai i kushtoi vëmendje të madhe zhvillimit mendor të njerëzve, duke e quajtur këtë si një kusht të domosdoshëm dhe të rregullt në përparimin e popujve të botës.

Sami Frashëri, me gjithë të metat që ka në mos zgjdhjen deri në fund të disa problemeve të veçanta filozofike, në animin nga deizmi dhe nga eklektizmi, prapë-serapë ka çfaqur e propaganduar mendime shumë përparimtare për ambientin e prapambetur turk dhe shqiptar të asaj kohe.

Bile edhe deizmi në kushtet e sundimit të botëkuptimit feodal muhamedian ishte shpesh një formë e fshehtë e ateizmit, ishte një mjet i përshtatshëm dhe i lehtë i materialistëve për t'u shkëputur nga feja.

«Deizmi — të paktën për materialistin — thotë Frederik Engelsi — nuk është gjë tjetër veçse një mënyrë e mirë dhe e lehtë për t'i larë hesapet me fenë».

Gjuha dhe mendimi

Sami Frashëri ishte një linguist i madh në Lindje: Ai shkroi gramatikën e parë shkencore të gjuhës shqipe dhe duke u marrë me punën e fjalorëve ai bëri fjalorët e gjuhës turke, arabe dhe të gjuhëve të tjera; ai së bashku me Naimin filloi të pregetiste gjithashtu fjalorin e gjuhës Shqipe.

«Fjalori — ka shkruar Samiu — është thesari i kombit».

Ai, ka shkruar libër të veçantë për gjuhën me titull «Gjuha» (Lisan), që përbëhet nga 18 kapituj, botuar në vitin 1887. Në këtë libër ai flet për origjinën e gjuhës, për ndryshimin midis njeriut dhe kafshëve si dhe për çështje të tjera të gjuhësisë. Midis linguistëve të shekullit XIX morën përhapje të gjerë sidomos dy teoritë biologjike mbi origjinën e gjuhës: teorija e imitimit të tingujve dhe teoria e pasthirmave.

Në gjuhësinë borgjeze u përhapën gjerësish teoritë fetare mbi origjinën e gjuhës.

Është e kuptueshme se në këto kushte ai nuk mundi të kuptojë zhvillimin shoqëror të njeriut, ai gjithashtu nuk mundi të kuptojë karakterin shoqëror të mendimit dhe të gjuhës.

Dihet se shpjegimi i lindjes së gjuhës nga procesi i punës dhe së bashku me punën, është i vetmi shpjegim i drejtë: «Njerëzit, që po formohen — thotë F. Engelsi — arriten në atë gjendje që ndër ta të çfaqej nevoja për t'i thënë diçka njeri tjetrit. Nevoja krijoi organin e vet: larinksi i pa zhvilluar i majmunit u shndrua me ngadale, por gjithënjë më tepër me anë të modulacionit dhe u bë i aftë për një modulacion më të zhvilluar, kurse organet e gojës, dalngadalë

u mësuan të shqiptonin njeri pas tjetrit tinguj të artiku-lluar».

Tek Sami Frashëri ne gjejmë mendime të drejta dhe interesante në lidhje me mendimin dhe gjuhën. Ai pranon se midis gjuhës dhe mendimit ekziston lidhje reciproke.

«Idetë thotë K. Marks — nuk janë të ndara nga gjuha».

Edhe Samiu nuk e ndan mendimin nga gjuha.

«Gjuha — shkruan ai — është një organ i trupit, nga e cila mjekët kuptojnë shëndetin e trupit dhe të urtët shëndetin e truve».

Samiu e zgjidhi çështjen në mënyrë materialiste: Ai thotë se gjuha është një mjet komunikimi midis njerëzve, një mjet shkëmbimi mendimesh në shoqërinë njerëzore. «Gjuha — shkruan ai — është një nga karakteristikat kryesore të njeriut. Është mjeti për të çfaqur mendimet e tij».

J. V. Stalini për gjuhën shkruan kështu: «Gjuna i shërben shoqërisë si një mjet, që u jep mundësi njerëzve të kuptojnë njeri tjetrin dhe të organizojnë punën e përbashkët».

Sami Frashëri, duke u mbështetur në teorinë borgjeze biologjike të onomatorësë, nuk mundi të kuptonte karakterin shoqëror të origjinës së mendimit dhe të gjuhës. Samiu siç duket pranon tezën se gjuha ka filluar me imitim e zérave të natyrës dhe të shtazëve.

«Gjuha — ka shkruar Samiu — nuk është e motëshme sa njeriu, ajo ka dalë më vonë».

Mund të themi se me këtë ai kupton që gjuha ka dalë vetëm në shoqërinë njerëzore, sepse tek gjuha ai shikon dallimin kryesor të njeriut nga kafshët. Ai njëkohësisht me ketë hedh poshtë pikëpamjet fetare mbi origjinën e gjuhës.

«Gjuha — ka shkruar ai — është shënja kryesore e kombit».

Sami Frashëri pranon zhvillimin historik të gjuhës. Ai ka thënë se gjuha lind, zhvillohet dhe vdes. Ai ka treguar se gjuha në fillim ka qënë shumë e thjeshtë, por «zhvillimi i gjuhës bëhet shumë ngadalë dhe se ky zhvillim ka lidhje me evolucionin e njeriut».

Gjuha që përbledh fondin e fjalëve dhe *strukturën gramatikore*, nuk mund të shikohet si prodhim i një periudhe të shkurtër kohe, por si prodhim i një sërë epokash

Samiu fjalorin e quan si visarin e një gjuhe. Ai kupton rëndësinë e madhe të fondit të fjalëve, të gramatikës dhe të sintaksës.

«Kapitali i gjuhës — shkruan ai — përbëhet prej fjalësh e prej rregullash morfollogjike e sintaksore».

Sami Frashëri, duke punuar me fjalorin e turqishtes, analizon dhe u jep zgjidhje disa çështjeve teorike në gjuisi.

«Një gjuhë që nuk ka të mbledhur fjalët dhe rregullat gramatikore — ka shkruar ai — nuk mundet kurrë të pretendojë se është një gjuhë letrare. Fjalori dhe gramatika janë bazat e letërsisë: Ndërsa letrare qëndron vetëm mbi «to».

Samiu shtron tezën e tij se në të vërtetë gjuha në procesin e zhvillimit të sai ~~pasurohet~~ me fjalë të huaja, por ky princip duhet të mbështetet në dy kushte të domosdoshme: *së pari*, kur gjuha ka fjalën e saj që është e qartë dhe e vjetër, atëherë nuk duhet të zëvëndësoshet ajo me një fjalë të huaj, që është e pakuptueshme për popullin; *së dyti*, fjalët e reja duhet t'u përputhen ligjeve të gjuhës. Por njëkohësisht ai ishte kundër purizmit të platë.

Fjalori i gjuhës turke «Kamusı Turki» është njëkohësisht një fjalor etimologjik dhe ka rëndësi të madhe për gjuhën turke.

Në vitin 1932 Kongresi i shkrimitarëve të Turqisë që u mblohdh në Stamboll, e pranoi këtë vepër si bazën e gjuhës së re letrare turke.

Sami Frashëri është një nga pionerët e alfabetit të soçëm të gjuhës turke, i cili u vu në përdorim vetëm në vitin 1937.

«Il faut — ka shkruar Sami Frashëri më 1883 në parathënien e Fjalorit turqisht - fréngjisht - faire de l'alphabet latin un alphabet turc».

Akademiku V. A. Gordlevskij shumë drejt ka shkruar në vitin 1912 se «Shemsedin Samiu me origjinë shqiptare ka të ngjarë të ketë bërë më tepër se dhe vetë turqit pér studimin e gjuhës turke».

Ai i kushtoi një kujdes të madh edhe gjuhës amtare.

Samiu dhe Naimi në letrën, që i kanë dërguar Murat efendiu në vitin 1898 shkruajnë kështu pér gjuhën shqipe: «Armiqtë e kombit tonë donin të na gjenjenin c'prej kohe se gjoja gjuha shqipe është një gjuhë e prishur dhe trashamane, se nuk shkruhet dhe se nuk mund të shkruhet, se s'ka gramatikë, se me të nuk mësohen shkencat e tjera. Por në fund panë se shqipia u bë, u shkrua, u krijuat alfabeti i saj, u hartua gramatika, u shtypën librat e shkencës, u përkthyen poezi të bukura prej çdo gjuhe të huaj. Me një fjalë u kuptua se c'gjuhë e përsosur dhe e rregulltë është Shqipia».

Elemente të dialektikës në veprat e Sami Frashërit.

Në shekullin XIX zhvillimi i mendimit filozofik ishte i lidhur ngushtë me sukseset e shkencave, veçanërisht me shkencat e natyrës të asaj kohe.

Mësimet e Lomonosovit, të Kantit, të Laplasit dhe të shkencëtarëve të tjerë të përparuar zbuluan zbrzesinë e kuptimit metafizik të natyrës.

Zbulimet e shkencave të natyrës prebatitën terenin pér krijimin e teorisë së zhvillimit. Sami Frashëri duke u mbështetur në sukseset e shkencave të natyrës së asaj kohe u përpooq që të kuptojë drejt natyrën. Në kushtet e Turqisë despotike dhe të ambientit mistiko-fetar kjo pati rëndësi të madhe. Në veprat e tij gjenden disa mendime të drejta në kuptimin e zhvillimit të natyrës dhe të shoqërisë.

«... Në botë — thotë ai — gjithçka ndryshon, zhvillohet, rritet, plaket, çduket dhe më në fund del prapë në shesh në një trajtë tjetër».

Samiu pranon zhvillimin e pandërprerë nga e thjeshtëta në të ndërlikuarën, lëvizjen dhe transformimin e materjes nga njera formë në tjetrën. Ai ka shkruar se bota e kafshëve dhe njeriu gjithmonë janë zhvilluar dhe vazhdimisht po zhvillohen pa ndërprerje. Ai njeh procesin e evolucionit.

Sami Frashëri, duke u nisur nga të dhënat shkencore pranon lëvizjen e pandërprerë të botës në tërsësi.

«Gjithçka në natyrë — shkruan Sami Frashëri — vërtitet dhe lëviz. Edhe yjtë për të cilët thuhet se janë të qëndrueshëm, në të vërtetë nuk janë të tillë, por lëvizin. Sejcili prej tyre përvrëç që vërtitet në boshtin e vet, të gjithë këta vërtiten edhe së bashku d. m. th. bota në tëresinë e saj vërtitet».

Dihet se materialistët francezë lëvizjen e konsiderojnë si zhvillim në rrëth të mbyllur. F. Engelsi duke kritikuar mënyrën metafizike të të menduarit, vë në dukje meritën e madhe të filozofisë së re gjermane, që u kthye te dialektika si forma më e lartë e të menduarit. Ai thotë se kjo mënyrë metafizike e mendimit kishte pushtuar pothuajse plotësisht edhe francezët e shekullit XVIII.

Sami Frashëri pohon se lëvizja dhe zhvillimi shkojnë pa ndërprerje në vijë progresive. Për këtë neve na bind pikëpamja e tij mbi zhvillimin e pandërprerë të qytetërimit. Ai njeh zhvillimin historik të shoqërisë njerëzore dhe është i mendimit se në shoqërinë njerëzore bëhen ndryshime të vazhdueshme kualitative. Ai është kundër mënyrës metafizike të shpjegimit të fazave të qytetërimit.

«Një qytetërim më i vonshëm — shkruan Samiu — është gjithëmonë më i përsosur se qytetërimi më i herëshëm».

Sami Frashëri ka çmuar qytetërimin e Greqisë së vjetër; por duke u nisur nga principi i zhvillimit pa ndërprerje, me të drejtë ka pohuar se qytetërimi i soçem evropian është më i lartë se qytetërimi islam (ai ka

parasysh qytetërimin e Lindjes në kohën e mesme — E.R.) dhe si rrjedhim më i lartë se qytetërimi i Greqisë së vjetër.

Samiu, duke folur për lidhjen e ngushtë të historisë me gjeografinë, në parathënien e Kamusi Alamit (Fjalor biografik-gjeografik) shkruan kështu: «Nuk jep asnje fryt të mësosh një ngjarje pa ditur vendin se ku ka ngjarë ajo».

Një kuptim i tillë dialektik i procesit të zhvillimit e lejon Sami Frashërin që t'i analizojë drejt disa çështje të rëndësishme.

Ai kuptoi drejt lidhjen e ngushtë të kohës e të hapësirës.

«Historia — shkruan ai — është koha dhe gjeografia është vendi. Koha dhe vendi natyrisht kanë lidhje ndërmjet tyre».

Samiu kuptoi karakterin e ndryshimeve në natyrë edhe në shoqëri.

«Hapësira — vazhdon ai — me përjashtim të disa ndryshimeve fort të ngadalëshme, që pëson gjeologjikisht, mbetet po ajo. Por ndryshojnë njerëzit e veprat e tyre. Shkenca e historisë është më e gjerrë se ajo e gjeografisë për shkak se ndryshimet dhe kontradiktat janë më të mëdha në histori».

Kjo thënie e Sami Frashërit është krejt e drejtë. J. V. Stalini, duke bërë fjalë për rolin e ambientit gjeografik në zhvillimin e shoqërisë shkruan: «Ndryshimet dhe zhvillimi i shoqërisë bëhen shumë më shpejt se ndryshimet dhe zhvillimi i ambientit gjeografik».

Sami Frashëri e kuptoi se «në botë çdo gjë është relative me kohën dhe me vendin».

Në lidhje me çështjen e njohjes së botës, që na rrëthon, midis filozofëve gjatë shumë shekujve janë bërë dhe po bëhen diskutime të ashpra.

E vërteta është se ai nuk i analizon në mënyrë të veçantë çështjet e teorisë së të njohurit, por në veprat e tij ne gjë më mendime, që na habisin dhe që ai, lidhur me këtë çështje, qëndron në pozita materialiste.

Pohimi i Sami Frashërit se «në shkencë nuk ka udhë që të mos kalohet», na bind se ai kishte besim në fuqinë e shkencës. Samiu në fakt ishte kundërshtar i agnosticizmit — teori idealiste, që thotë se nuk mund ta njo him botën. Agnosticizmi arriti zhvillimin e tij më të madh në filozofinë borgjeze të givsmës së dytë të shekullit XIX dhe në fazën e imperializmit.

Tamam në këto kushte Sami Frashëri, jo vetëm që përkrah pikëpamjen e mundësisë së njojjes së botës, por ai u bën thirje të njojin natyrën dhe të çfrytëzojnë pasuritë e saj për mirëqënen e gjithë njerëzisë.

«Njerëzit — shkruan ai — kanë një detyrë të madhe të njojin natyrën dhe të vërtetën e materjeve që gjënden në botë e vecanërisht mbi lëmsh të Dheut tonë, të dinë të përfitojnë nga cilësitë e atyre materjeve dhe t'i shtien ato në punë për mirëqënen e mbarë rruzullimit».

Këto rreshta të shkruara 70 e ca vjet më parë kanë rëndësi të madhe edhe në kohën e sotme. Zbulimet e mëdha në lidhje me energjinë atomike dhe hedhja e raketeve kozmike janë një sukses i madh i shkencëtarëve dhe i të gjithë popujve.

Sami Frashëri dhe vëllai i tij Naimi, i cili kishte po ato pikëpamje ideologjike sikundër Samiu, ishin përkrahës të asaj filozofije, që i shërbente njerëzisë.

«Është m'e vjejturë shkruan Samiu — fjal' e Dekartit, i cili është nga filozofët e rinj që thotë: pse të merremi me punëra, që s'na sjellinë ndonjë mirësi?... Të marimë vesh q'janë gjérerat, që na sheh syri..., të mësojmë se q'janë, e me këtë mënyrë njeriu të bëhet zot i natyrës».

Naimi dhe Samiu morën anën materialiste të filozofisë dualiste karteziane. Në kohën e Bekonit dhe të Dekartit filozofia tregoi një interes të madh për zhvillimin e forcave prodhuuese.

Sami Frashëri thotë se jo çdo e vërtetë është përfundimtare, e plotë dhe e pandryshueshme.

«Shkenca — shkruan ai — pohon se mendja njerëzore nuk mund të zbulojë gjithë të fshehtat...»

Ai shqyrtoi në mënyrë kritike çështje të ndryshme dhe na mësoi se për çdo çështje njeriu duhet të japë mendimin e vet.

«Një ndër detyrat e historianit — shkruan Samiu — është të mos i besojë çdo gjëje që sheh të shkruar në libër. Ai duhet të krahasojë ngjarjet, të shoshisij burimet, të formojë idenë dhe më në fund të japë gjykimin e vet».

Sami Frashëri propagandoi teoritë e përparuara shkencore. Dukë kërkuar thellimin në shkencë, ai kritikoi njerëzit e përciptë. «Zbulimet e deritanishme — shkruan ai — janë bërë nga ata, që kanë bredhur nëpër rrugët e ngushta të dijes e të artit».

Çështja e lidhjes reciproke midis filozofisë dhe shkencës kishte rëndësi të madhe në këtë periudhë. Samiu u muan shumë me shkencat e natyrës dhe tha se filozofi duhet të përvetësojë sukseset që ka arritur shkenca.

«Dyshimi — shkruan ai — është kriteri i së vërtetës. Kurrë nuk mashtrohet ai, që bën dyshim në punë. Kush dyshon në çështje shkencore bëhet filozof».

Në këtë mënyrë ai iu afrua mendimit që filozofia dhe shkenca të zhvillohen në lidhje shumë të ngushta me njera tjetren. Samiu me fjalën dyshim kuption thellimin, argumentimin mbi baza shkencore dhe mosbesimin në mënyrë të verbër. Kështu sipas tij filozof mund të bëhet vetëm ai, që përvetëson shkencën dhe që hyn thellë në problemet e saj.

Në lidhje me këtë çështje V. I. Lenini vë në dukje rëndësinë e madhe të lidhjes reciproke midis filozofisë dhe shkencave të natyrës. Në artikullin «Mbi rëndësinë e materializmit luftarak» V. I. Lenini u bën thirrje materialistëve dialektikë të forcojnë «lidhjen me përfaqësuesit e shkencave të sotme të natyrës».

KAPITULLI VI

PIKËPAMJET SHOQËRORE-POLITIKE TË SAMI FRASHËRIT

«O filozof, opinioni publik, që tifluk e pëlgjen është shumë më mevend se mendimi yt, pse n'atë përmblidhen mendimet e sa e sa miliona njerëzve, kurse mendimi yt mund të jetë vetëm ai i pesë ose gjashtë vjetëve»

S. Frashëri.

Sami Frashëri në pikëpamjet e tij për jetën shoqërore mbeti në pozitat e idealizmit. Sipas mendimit të tij shkaku kryesor dhe forca lëvizëse, që është bázë e zhvillimit historik, e përparimit të shoqërisë, qëndron në përsosjen e fuqive mendore të njerëzve dhe të dijeve të tyre. Ai ka menduar gabimisht se arësimi dhe edukata lozin rolin kryesor në fatet e popujve. Vetëm Marksia dhe Engelsi bënë një kthesë të madhe në historinë e mendimit duke zbuluar ligjet e vërtetë të zhvillimit shoqëror. Ata treguan se zhvillimi i shoqërisë kondicionohet jo nga mendimet, por nga mënyra e prodhimit të vlerave materiale. Por duhet vënë në dukje se në kushtet konkrete historike të Turqisë së sulltanit, pikëpamjet iluministe të Sami Frashërit qenë një hap i rëndësishëm përpara në krahasim me ato mistiko-fetare të dogmatikëve, sipas të cilëve botën e drejtoka «zoti».

Samiu, duke u nisur nga teza, që pranon zhvillimin gradual nga shkalla e ulët në më të lartë, kuptoi karakterin gradual të zhvillimit progresiv të shoqërisë njerëzore. Kjo pikëpamje ka rrjedhur nga kuptimi materialist i zhvillimit të natyrës.

Megjithëse Samiu nuk e kishte të qartë kuptimin shkencor për shkallët e zhvillimit të shoqërisë, prap se prapë ai tregoi se njerëzia zhvillohet në vijë progresive.

Interes të madh paraqet kritika e Sami Frashërit kundër teorive reaksionare të superpopullatës.

Sipas kësaj teorie antinjerëzore të Maltusit njerëzimi shtohet në përpjestim gjeometrik dhe në këtë mënvrë ushqimet janë të pamjaftueshme. Nga kjo teori reaksionare sociologët borgjezë nxjerrin si konkluzion se luftërat janë të domosdoshme dhe të natyrëshme.

Samiu është kundër kësaj pikëpamje antinjerëzore. Ai ka besim në sukseset e shkencës dhe në burimet e pashterueshme të natyrës për të ushqyer njerëzinë. Ai vë re faktin se një piesë e madhe e pasurive të botës shkon kot dhe jo për të mirën e njerëzisë.

«Toka — shkruan Sami Frashëri — mjafton të ushqejë njerëzit më së miri, sikur e shumta e pasurisë të mos prishej kot; nga ky shkak njerëzit vuajnë nga urija».

Samiu, duke konkretizuar këtë mendim, ka shkruar me besim të madh për të ardhmen e lumtur të atdheut të tij të dashur.

«Me një fjalë, Shqipërija, — shkruan ai — sa do që është e vogël, ka çdo farë klime e çdo farë dhe edhe shumë bagëti e shumë të mira. Të vështrohet mirë, mund të vejë shumë mbarë e të ushqejë 4 herë më tepër njerëz se sa ushqen sot».

Sami Frashëri ka ëndëruar për marrëdhënie miqësore midis popujve të gjithë botës, marrëdhënie të bazuara në parimet e bashkëpunimit.

«Sikur të gjithë njerëzit të kishin qënë të grumbulluar në një vend të botës, — shkruan ai — sikur të kishin patur të njëjtën gjuhë dhe të shkonin mirë me njeri tjetrin, duke mos u përcarë nga asnje mëri e armiqësi, sigerisht që do të ecnin të gjithë së bashku në udhën e qytetërimit dhe do t'i dilnin në krye kësaj udhe më shpejt e më lehtë».

Sami Frashëri i dalloi luftërat e dreita dhe ato të padrejta. Ai ishte kundër luftërave të padrejta dhe kritikoi ashpër pushtonjësit e tokave të huaja. Samiu përkrahu



Samiu me gruan dhe me fëmitë
dhe Naimi me gruan e vajzën.

nxehtësish luftërat e drejta, çlirimtare, të popujve kundër pushtonjësve të huaj. Ai luftën zaptontë e quante si një fenomen antinjerëzor dhe që, sipas tij, nuk ishte veti e njerëzve.

Sigurisht ai nuk arrin dot që të kuptojë origjinën sociale të luftës, por, sidoqoftë pikëpamjet e tij, si mbrojtës i paqës dhe partizan i flaktë i luftërave të drejta për liri e pavarësi, kanë karakter progresiv.

«Lufta — shkruan ai — ka kaluar ndër njerëz nga bishët e egra. Paqia është vetia e natyrëshme e njerëzve».

Demokrati Sami Frashëri e çmonte shumë punën e njerëzve. Ai mendonte se njerëzit duhet të mësojnë mjeshtëri të ndryshme që t'i shpëtojnë varfërisë.

«Mjeshtëria, — shkruan ai — është një mbrojtje kundër varfërisë».

Samiuë endëronte për industrializimin borgjez dhe për demokratizimin e vendit. Ai thoshte se puna i sjell njeriut të ardhura të mëdha dhe se të gjithë duhet të punojnë. Samiuë u përpoq që të ngallte në njerëzit dashurinë për punë; ai luftoi përtacinë, që ishte karakteristikë e regjimit të Turqisë feudale-ushtarake.

Dihet se puna vetë nuk mund të jetë burimi i pasurisë, pa veglat e prodhimit. Samiuë si ideolog me pikëpamje progresive borgjeze në luftë kundër sistemit feudal, nuk e ngre çështjen e mjeteve të prodhimit.

K. Marks i nё librin «Kritika e programit të Gotës» tё botuar pёr herë tё parë nga Engelsi në vitin 1891, kritikoi ashpёr pёrbajtjen oportuniste tё programit Lasanian, ku thuhej se «Puna është burimi i çdo pasurie dhe i çdo kulture».

Nё fakt ky është një grumbull fjalësh pa kuptim dhe një argumentim i borgjezisë e cila thotë: «Puno dhe ti se shpejt ose vonë do tё bëhesh i pasur!»

Karl Marks duke kritikuar programin e partisë punëtore gjermane shkruan kështu:

«Puna nuk është burimi i çdo pasurie. Natyra është po aq burim vlerash konsumi (dhe këto përbëjnë pikërisht pasurinë reale!) sa edhe puna, e cila nuk është gjë tjetër, veçse çfaqje e njerës prej forcave të natyrës, e forcës punëtore të njeriut. Frazën e mësipërme ju do ta gjeni në çdo abetare për fëmijët, dhe ajo është e drejtë, po të nënkuptohet se puna kryhet, kur ekzistojnë mjetet dhe veglat përkatëse. Por një program socialist nuk duhet të lejojë shprehje të tillë borgjeze, duke lënë në heshtje kushtet, të cilat janë të vetmet që u japid atyre një kuptim; puna e njeriut bëhet burim vlerash konsumi pra edhe burim pasurie, në qoftë se njeriu vepron si zot i natyrës, e cila është burimi i parë i të gjitha mjetave dhe sendeve të punës, në qoftë se ai e trajton atë si një gjë që i përket».

Sami Frashëri i urrente parazitët dhe përgjithësisht ata njerëz, që rronin në kurriz të të tjerëve.

«Në ka njeri më të dëmshëm për shoqërinë njerëzore — thotë Samiu — është ai, i cili jeton me të ardhurat e një qifligu, që s'e punon vetë ose me kamatën e të hollave, që ka lëshuar me interes».

Ai i urrente kopracët dhe fajdexhinjtë, që shfrytëzonin fshatarët e varfër.

Samiu njohu gjithashtu fuqinë e madhe të ideve dhe të parimeve të bashkëpunimit midis popujve të kombësive të ndryshme. «Bashkimi i ideve dhe i parimeve — thotë ai — është më i fortë se bashkimi i kombeve».

Ai ishte për vendosjen e marrëdhënieve të mira miqësore me popujt e tjerë fqinjë dhe kishte urrejtjen më të madhe kundër zaptonjësve dhe shovinistëve.

«Marrëdhëniet e mira, që ekzistojnë në mes dy familjeve fqinje — shkruan Samiu — duhet të ekzistojnë edhe në mes dy shteteve fqinjë».

Samiu çmoi drejt vetitë e mira, që ka çdo komb, qoftë dhe ai më i vogli dhe më i prapambetur.

«Po të vështrohen me vërejtje kombet e botës — shkruan Samiu — s'ka asnjë komb, qoftë dhe i prapambetur që të mos ketë veti të bucura e pak' a shumë zakone të mira».

Samiu mendon se për të zhdukur zakonet e këqia të një populli, nuk duhet të përdoret forca, por të veprohet në atë mënyrë që ai të ngrihet n'atë shkallë sa të largohet vetë me ndërgjegje nga ato zakone të këqia.

Sami Frashëri e donte me gjithë shpirt popullin e tij dhe luftoi pa u lodhur për bashkimin, lirinë dhe pavarësinë e tij.

«Për njerinë në këtë jetë — shkruan ai — s'ka gjë m'e vlejturë, m'e dashurë se kombësija... Ai që s'do kombin e mëmëdhenë e tij është trathëtor e i lik; i tillë s'mund të quhetë njeri».

Ai ishte admironjës i sukseseve të shkencës dhe dëshironte që këto të përhapeshin në popull. Për këtë qëllim ai shkroi një sërë broshurash për popullarizimin e shkencës në masat e gjera të popullit duke luftuar kështu kundër obskurantizmit anadollak.

«...Një shoqëri — shkruan Samiu — duhet të tē përpigjet të ndreqë të metat e veta, duke mbajtur në dorë pasqyrën e shkencës».

Në vetë qendrën e perandorisë turke, ku sundonte absolutizmi i egër i sulltan Hamitit II, Sami Frashëri, me gjithëse gjurmohet nat' e ditë nga spiunët, qfaqi mendimet e tij përparamtare me guxim dhe me trimëri dhe shtroi detyrat urgjente e të domosdoshme për të ardhmen e popullit shqiptar.

Detyra kryesore përpara popullit shqiptar në shekullin XIX ishte çlrimi i vendit nga zgjedha turke.

Për zgjidhjen e kësaj detyre themelore klasat dhe shtresat e ndryshme shoqërore të vendit mbajtën qëndrime të ndryshme. Borgjezia dhe inteligjenca e re përparamtare, që në pjesën më të madhe ishte e lidhur me tregun e brendshëm, kërkonte pavarësinë e plotë nga sundonjësit turq si dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Samiu revolucionar ishte përkrahës i pavarësisë së plotë dhe i demokratizimit të vendit.

Pikëpamjet e tij shoqërore-politike duken më qartë dhe më mirë në librin e shkruar në gjuhën shqipe me titull: «Shqipëria ç'ka qënë. ç'është e ç'do të bëhetë?»

**Përbajtja dhe idetë kryesore të librit
«Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhetë?»**

Kjo është vepra më e rëndësishme që ka shkruar Sami Frashëri në gjuhën shqipe, sepse shtron detyrat tak-tiko-strategjike të lëvizjes kombëtare të popullit shqiptar. Ajo është përkthyer në turqisht, greqisht, gjermanisht, bullgarisht dhe italisht. Libri ndahet në tri piesë: mbi të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen e Shqipërisë.

Në kapitullin e parë Samiu paraqet historinë e shkurtër të origjinës së popullit shqiptar. Më këtë ai kishte për qëllim të zgjonte në popull krenarinë kombëtare dhe të tregonte se populli shqiptar ishte i pathyeshëm në luf-tën e tij për liri.

Sami Frashëri e lavdëron ra të drejtë kohën para tanzimatit, sepse ai besonte në zbatimin e reformave nga lart. dhe shpresonte të tërhiqte edhe shtresat e larta në luftën kundër pushtonjësve për pavarësinë e plotë të Shqipërisë.

Sami Frashëri, i cili e urrente për vdekje monarkinë, lavdëron regjimin demokratik borgjez të vendeve evro-piane të asaj kohe dhe vë në dukje traditat demokratike të popullit shqiptar. Këto pikëpamje në kushtet e abso-lutizmit turk janë një hap i guximshëm dhe progresiv. Lufta kundër regjimit feodal - ushtarak për kërkesa demokratike është një hap përpara.

Mandej ai i kushton një kujdes të madh gjuhës shqipe, të cilén donte ta ngrinte dhe ta lëvronte në shkallë shkencore. Duke u nisur gjithmonë nga qëllime politike, ai vë në dukje vetitë e mira të gjuhës amtare për të têr-hequr popullin të mësojë e të shkruajë gjuhën e tij.

«Shqipëtarëtë — shkruan ai — flasin një nga më të vjetrat' e më të bukuratë gjuhë të dheut».

Përhapja e shkrimit dhe hapja e shkollave shqipe ishte një çështje e rëndësishme e lëvizjes kombëtare. Prandaj Samiu shkruan: «Po në e kanë ruajturë gjer më sot kombësinë, gjuhën e tyre me paditje e pa të shkruarë — a do të mundinë me këtë mënyrë ta ruajnë dhe paskëtaj, ndo në Shqipëri, ndo n'Itali e në Greqi? Jo, jo, kurre — përgjigjet ai».

Kështu Samiu kërkonte me këmbëngulje përhapjen e arësimit dhe përvetësimin e shkencës dhe kulturës. Kjo kërkësë merr një rëndësi të posaçme, po të merret parasysh prapambetja dhe padituria, që sundonte në atë kohë në të gjithë perandorinë turke dhe veçanërisht në masat e popullit shqiptar.

Patrioti Sami i bën thirrje gjithë popullit të krijojë frontin unik dhe kompakt për çlirim, shpëtimin dhe arësimin e Mëmëdheut.

Në pjesën e dytë të librit, Samiu ka paraqitur veçoritë gjeografike të Shqipërisë. Me ndjenja të thella dashurie për Atdheun e tij, ai ka përshkruar bukuritë mahnitëse të vendit të tij, natyrën e stolisur të Shqipërisë.

«Shqipëria — shkruan ai — mëmëdheu ynë i dashur është një nga më të bukurat’ e vëndeve t’Evropës». Ai, duke folur për kushtet e favorëshme të bujqësisë dhe të blegtorisë në Shqipëri, ka shkruar kështu: «Sikur të ishte një qeveri që t’u tregonte lehtësi e t’u hapte udhënë e të dinin edhe mësimn’ e bagëtivet qysh shtohenë, qysh ngjallënë e qysh rritet e zbukurohet far’ e tyre, do të muntninë të roninë edhe vetëm me bagëti».

Sami Frashëri flet për veçoritë më të mira të veteqeverisjes së masave punonjëse të Shqipërisë. «Shqiptarëtë — shkruan ai — janë trima, të mënçimë, punëtorë, të zottë për çdo punë. Me gjithë ndryshimet e besëvet nukë janë të ndar’ e të çarë, po të bashkuarë, kanë dashurinë në mes të tyre. Kanë domethënë gjith’ ato që duhet të ketë një komp për të vajturë mbarë».

Duke shkruar për jetën e rëndë dhe vuajtjet e popullit tonë ai thotë se Turqia i pi gjakun pënullit. «Vete edhe zaptia e taksidari — shkruan ai — e ngre shkojn’ e i rreh, duke thirrurë paguani! E ku të gjen’ i ziu që të paguanjë? Atëherë i shesinë kanë dhinë, ç’të ketë edhe gjer më qiramidhet e shtëpisë! Shqipëtari të hajë dru për të paguarë!! O ç’turi i madh! O ç’e madhe e keqe! Mos e durofsh o Perëndi!»

Sami Frashëri e kuptoi rrezikun që paraqiste borjezia shoviniste e vendeve të huaja, e cila përpiquej ta copëtonte Shqipërinë.

Patrioti Sami Frashëri kishte besim se dhe Rusia do ta përkrahte Shqipërinë kundër kërkesave të shovinistëve serbë. «Edhe Rusia, q'është vetë Shqah edhe mburonjëse e gjithë shqehet, edhe ajo nuk e kurser fjalën e mirë e ndihmën për Shqiptarëtë, sikundër s'e ka kursyerë kurrë edhe për Grekërit me gjithë që këta s'e duan edhe janë armikët e Shqahërisë».

Në pjesën e fundit, që zë gati gjysmën e librit, Sami Frashëri analizon problemet e detyrat e lëvizjes kom-bëtare dhe parashtron idetë për ndërtimin e ardhshëm shtetëror dhe për zhvillimin ekonomik e kultural të Shqipërisë së pavarur. Sami Frashëri e sheh të domosdoshme dhe kërkon me këmbëngulje në mënyrë revolucionare rrëzimin e perandorisë turke. «Turqia — shkruan ai — a do të ronjë edhe shumë kohë në Evropë? Kësaj pyetje je njeri s'i përgjigjet dot e përgjegj' e kësaj është jo. Turqia rojti shumë n'Evropë».

Si rrugëdalje për të shpëtuar nga sundimi turk, Samiu i tregon popullit rrugën e luftës, rrugën revolucionare. Ai kërkon që t'i jepet Turqisë një grusht i fortë duke besuar se «nuk ka gjuhë më të mirë se shpata». «T'i japë — shkruan ai — një shqelm të shëndoshë këti tra-thëtori, që kërkon ta mbytnjë, ta dërgonjë në funt të de-tit edhe të shpëtonjë vehten' e ti. Kjo është udh' e shpë-timit, e jo tjetërë.» Dhe më poshtë: «Turqia as munt të ronjë paskëtaj, as do të ronjë, edhe as duhetë të ronjë... ngallje e Turqisë është vdekje e Shqipërisë».

Samiu dhe bashkëkohësit e tij revolucionarë në kushtet e regjimit feodalo-ushtarak të Turqisë përdorën tak-tika të ndryshme, por strategja e tyre nuk ndryshoi. Ata ishin të matur dhe tejpamës në politikë. Ata për të arri-tur qëllimin — pavarësinë e plotë të Shqipërisë — ecnin me takt, përdornin të gjitha mundësitë reale, por ata e shih-nin në sy të vërtetën dhe e dinin se mik i vërtetë i pa-varësisë së Shqipërisë atëhere ishte vetëm populli shqip-tar, sepse shtetet e mëdha duan copëtimin e Shqipërisë. «Të mendojmë mirë punënë tonë — shkruan Samiu — e të përpinqemi vetë për punët të vetë se në këtë jetë se-cilido përpinqetë për vetëhe».

Për të vepruar në mënyrë përfundimtare duhesin dhe kushtet e nevojshme. Për këtë arësy Samiu dhe udhëheqës të tjerë të lëvizjes kombëtare të fundit të shekullit XIX ndoqën që nga fillimi, politikën e autonomisë së Shqipërisë, dhe pastaj më vonë, politikën e pavarësisë së plotë. Duke shqyrtauar çështjen në tërsi, Samiu dhe bashkëkohësit e tij ishin përkrahës deri në fund të luftës së armatosur për pavarësinë e plotë të Shqipërisë. Ata i mësonin brezat e rinj që të besonin në forcën e popullit dhe të luftotonin për çlirimin e Atdheut dhe për lumturinë e popullit.

Samiu duke pohuar, se dhuna është mënyra më e mirë në luftën për pavarësinë e Shqipërisë, kishte besim në fitoren e kryengritjes së popullit shqiptar. Ai shumë kohë përpara ka menduar për shkëputjen e plotë të Shqipërisë nga Turqia. «Këtë herë — i shkruante ai Giollamò de Radës në vitin 1881 — Shqipëtarët e kuptuanë fort mirë që mbretëria nukë do të bënë gjë kurrë për 'ta edhe Lidhja e Prizrendit pa nevojë t'e bashkonjë Shqipërinë e t'e bënë një me otonomi, a mbasse me çkëputje fare, pas punës».

Sami Frashëri imbrojti tezën për shkëputjen e shpejtë të Shqipërisë nga perandoria turke. Ai bëri thirrje për mobilizimin e gjithë energjive luftarake të vendit dhe e mësoi popullin se si të luftojë me të gjitha forcat për çështjen e tij të drejtë — për çlirimin dhe demokracinë. Shpëtimin e vendit ai nuk e priste nga të tjerët, dhe aqë më pak nga shtetet borgjeze kapitaliste.

«Të shpëtuarët — shkruan ai — a të humburit' e Shqipërisë është në dorët të Shqipëtarëve; në daçinë, do të shpëtojnë, në daçinë do të humbasinë».

Samiu me besim të madh thoshte se shqiptarët janë të zotë të mbajnë dhe të ruajnë vetenë. Ai mendonte se krahas me të drejtën duhet të jetë edhe forca. «Dy gjëra — shkruan ai — duhen në këtë jetë: e drejta edhe fuqija. E drejta pa fuqi, si edhe fuqija pa të drejtë, është si një krah i vetëm; nonjë zok' s'fluturon dot me një krah».

Samiu revoltorët nga qëndrimi negativ i Turqisë feudalo-ushtarake dhe i vendeve kapitaliste karshi Shqipërisë. Ai kishte besim të thellë në forcën e popullit të

tij. Samiu ka thënë se shqipëtarët, si popull trim, mund të mbrojnë veten, sepse çështja e tyre është e drejtë.

«Nuk ka më të shënjtëruarë të drejtë se kombërija, gjuha e mëmëdheu për një komp — shkruan ai. Një trim që lëfton për plaçk' e për rrëmbim është kurdoher' i turpëruarë; ai që lëfton për një të drejtë të këtillë është dy herë trimi; e drejta i ep një forcë e një fuqi që s'e lë kurrë të mundetë, po e bën njerinë të muntnjë».

Sipas Sami Frashërit aleati më i mirë dhe më i fortë i popullit shqiptar është ai që lufton me të drejtë për atdheun. Ai përjashton nga kjo luftë feudalët shqintarë, të cilët gjithmonë kanë luftuar me forcë dhe asnjëherë më të drejtë.

Për të përballuar rrëzikun që paraqiste për pavareësi është e Shqipërisë shovinizmi i shteteve fqinj të Ballkanit, i cili kishte edhe ndihmën e shteteve kapitaliste të Evropës dhe të vetë qeverisë turke, Samiu kërkonte bashkimin e popullit në luftë kundër copëtimit. Samiu ishte përkrahës i luftës sulmuese. Ai e donte mbrojtjen, dhe tregonte se nuk është lufta mbrojtëse por lufta sulmuese ajo që të çon në fitore. Lufta çlirimtare sipas tij, duhej të ishte e rreptë dhe e vendosur:

«Kush të na qëndrojë përpëra — shkruan ai — e të na ndalonjë në këtë udhë të shënjtëruarë, t'a shtyjmë, t'a rrëzojmë, t'a shkelim' e të shkojmë tutje!»

Kushtetuta e shtetit të ardhshëm indipendent të Shqipërisë

Demokrati Sami Frashëri ishte armik i absolutizmit dhe i monarkisë, të cilën e urrente për vdekje. Ai, si përfaqësues i borgjezisë dhe inteligjencës përpëra imtare, kërkoi regjimin republikan sipas shëmbullit të shteteve borgaze të Evropës kundër absolutizmit, ai vuri regjimin demokratik-republikan.

«Në u bëftë dot Shqipëria më vehte — i shkruan ai De Radës — nuk do të kemi nevojë për përsëri, as të krishten' as muhametanë, që të na rrje pën e të na pinë gjaknë».

Pikëpamjet demokratike republikane të tij mbi shtetin janë formuar në kushtet e sundimit të plotfuqishëm të një njeriu të vetëm, d. m. th. të sulltanit. Në kushtet e absolutizmit turk, ku sultani ishte përfaqësues i shtetit dhe fesë, mendimet e Sami Frashërit janë përparimtare.

«Mendimi i popullit — thotë ai — e gjen më mirë të vërtetën, se sa mendimi i vetëm i mbretit».

Sami Frashëri ishte përkrahës i udhëheqjes kolegjiale dhe i luftës së mendimeve.

«Nuk duhet — shkruan ai — të presësh ndihmë prej atij, që nuk sheh nevojën të rahë mendimet».

Prandaj, duke u nisur nga këto pikëpamje, ai nuk donte në krye të Shqipërisë as mbret, as president të republikës, që kthehet shpejt në mbret, si p. sh. Napoleoni në Francë.

Samiu në librin «Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhet?» përcakton të drejtën e zgjedhjeve dhe ndërtimin shtetëror të Shqipërisë së ardhëshme të pavarur. Ai kërkon krijimin e një organi të vetëm kolegjial, të përbërë nga 15 veta dhe të zgjedhur nga populli. Ky këshill i pleqërisë zgjedh një kryetar, i cili nuk mund të veprojë pa mendimin e gjithë këshillit të pleqërisë «se — thotë Samiu — një njeri mund të gënjetet e të lajthinjë, po pesëmbëdhjetë njerëz të pjekur e të vuarë s'mund të lajthitinë të tërë».

Përveç Këshillit të Pleqërisë do të jetë dhe Këshilli i Përgjithshëm. Për çdo 20.000 vendës do të zgjidhet një përfaqësues në Këshillin e Përgjithshëm i cili do të përbëhet afersisht prej 100 vetësh.

Samiu cakton kushtet për zgjedhësit dhe për ata që do të zgjidhen në Këshillin e Përgjithshëm. Kjo është huajtur nga kushtetutat borgjeze dhe, në fakt, u pret rrugën shtresave të ulëta të popullit që të zgjedhin dhe të zgjidhen.

«Ata që do të zgjedhinë — shkruan Samiu — do të kenë mbushurë të 20 vjetët, do të kenë shtëpi, arë a çdo farë gjëje që t'i paguajnë të pakënë 5 copë (franga) në mot qeverisë, a të kenë dalë nga një shkoll' e të dinë të shkruajnë e të këndojojnë. Ata që do të zgjidhenë duhetë të kenë mbushur të 25 vjetët, të kenë shtëpi e dhë a tjetër gjë që ti paguajnë në mot qeverisë të pakën 10 copë a të kenë mbaruarë një shkollë të dytë a të lartë».

Këshilli i Përgjithshëm i Samiut është një nga llojet e parlamenteve borgjeze.

Kushtetuta e tij në një farë shkalle është origjinale, por në tërësi është e tipit të shteteve borgjeze. Samiu mundohet të kombinojë kushtetutat e vendeve evropiane dhe të Amerikës me materialet e nxjerra nga historia e vjetër e popullit shqiptar. Këshilli i Pleqërisë nuk ngjan me pallatin e lordëve në Angli, ku lordët nuk zgjidhen, kurse sipas kushtetutës së Samiut anëtarët e Këshillit të Pleqërisë zgjidhen.

Kushtetuta e Samiut ka karakter borgjez, sepse ajo u hap dyert në organet udhëheqëse shtresave të larta dhe borgjezisë. Ajo, në të vërtetë, kufizon demokracinë për të varfërit, sepse në Këshillin e Përgjithshëm mund të zgjidhen vetëm ata që kanë pronë private (shtëpi, tokë, etj.), që paguajnë 10 franga dhe që kanë arësim të mesëm ose të lartë.

Të drejtën për të zgjedhur e kanë vetëm ata, që mund të paguajnë 5 franga në vit dhe që dinë të shkruajnë dhe të këndojojnë shqip. Në këtë mënyrë ai përjashtoi nga e drejta e votimit shtresat më të varfëra të popullsisë. Nga kjo del kjartë se këtu pasqyrohet ndikimi i ideologjisë borgjeze dhe, njëkohësisht, dobësia e borgjezisë shqiptare, që nuk ishte e aftë për të udhëhequr masat e popullit në luftë kundër rendit feudal.

Qeveria — sipas kushtetutës së Sami Frashërit — ka në dorë pushtetin ekzekutiv. Qeveria dhe ministrat përgjigjen përparrë Këshillit të Pleqërisë dhe Këshillit të Përgjithshëm.

Kufizimi i kompetencave të qeverisë është karakteristikë e sundimit të borgjezisë në periudhën e lulëzimit të saj.

Në kushtetutën e pushtetit shtetëror të Samiut, i jetet një rëndësi e veçantë pushtetit lokal. Ajo u jep kompetenca të gjera pushteteve lokale për drejtimin e ekonomisë së vendit, të arësimit, të gjyqeve, të ndërmarrjeve të ndërtimit, etj. Organet e këshillave lokale zgjidhen nga populli.

Sipas kushtetutës së Samiut, vëndi do të ndahet në 15 ngastra dhe cilado nga këto do të ndahet në 3-4 nënngastra (kaza), nga të cilat e mezit do të qeveriset prej qeveritarit vetë dhe të tjerat prej nënqeveritarësh.

Sipas tij bazë e pushtetit lokal do të jetë *katundarija*. Çdo qytet i vogël do të quhet një kantundi (beledije), të mbëdhjenjtë do të ndahen në dy a më tepër katundi. Fshatrat që janë afër njeri tjetrit formojnë një katundi. Në mbledhjen e përgjithshme të katundarisë marrin pjesë gjithë burrat, që kanë shkuar të 20 vjetët, që kanë një farë pasurie, që paguajnë 5 franga në mot dhe që dinë të shkruajnë e të këndojnë.

Samiu thotë se katundaritë duhet të merren me punët e popullatës, të ekonomisë, të arësimit e tjera. Ai anong nga decentralizimi i shtetit; Samiu pushtetit lokal i beson kompetenca më të mëdha, gjë që shpie në demokratizimin e pushtetit.

Me gjithë kufizimet që vë ai, prapseprapë, mendimet e tij për republikën borgjeze dhe parlamentin, janë përparimtare në krahasim me rendin ekzistues feudal.

«Republika demokratike — shkruan V. I. Lenini — dhe e drejta elektorale e përgjithshme në krahasim me rendin feudal kanë qënë një përparim shumë i madh».

Samiu çfaq mendimin për krijimin e ushtrisë për mbrojtjen e pavarësisë së Shqipërisë. Ai mendoi për një shtet të atillë që të kishte mbështetjen e popullit dhe jo të forcës policore.

«Kur shteti — shkruan ai — shkon në rrugën e dëshirave të popullit, ai do të jetë njëqind herë më i fortë». Dhe më poshtë: «Populli është themeli i shtetit».

Por Sami Frashëri, nga një anë, duke folur për rolin e opinionit të masave dhe të mendimit kolegjial, nga ana tjetër, kupton dhe vlerëson drejt rolin progresist të individit, kur ai përfaqëson aspiratat dhe interesat e masave. Ja si ka shkruar ai: «Sa dobi u sjell anijeve feneri i një limani, aq dobi u bixe bashkatdhetarëve të vet një njeri i urtë. i matur e zemërmirë».

Duke menduar për shtetin e ardhshëm të pavarur të Shqipërisë, ai u kushton vëmëndje të veçantë pagave të nëpunësave të shtetit. Ai thotë se shpesh herë dy gjëra i prishin njerëzit e qeverisë d. m. th. pagesat e larta ose pagesat e ulta. Prandaj ai këshillonte që të jepeshin rroga mesatare. Ai donte që nëpunësat e shtetit të ishin të ndershëm. Vetë presidenti i Shqipërisë duhet të jetë shëmbull. Samiu duke urrejtur qeveritarët e korruptuar dhe kusarë të regjimit otoman, përmend fjalët e filozofit persian Saadi, i cili ka thënë:

«Po të marrë mbreti një vezë nga fshatari, ministrat e tij do të grabisin tërë pulat e katundit».

Shteti dhe feja

Sikundër dihet sulltani i Turqisë ishte njëkohësisht përfaqësues i zotit dhe i shtetit. Feja dhe shteti ishin të pandara nga njera tjetra.

Sami Frashëri kërkonte ndarjen e fesë nga shteti.

«Ulemaja, dervishëtë e priftërija do të mos përzehenë as në mësimet e në shkollat, përvèç mësimit të besësë».

Në shekullin e kaluar çështja e fesë në Shqipëri ishte shumë e ndërlikuar. Dihet se feja gjithmonë ka qënë végël e klasave sunduese dhe shfrytëzuese.

«Feja — shkruan K. Marksi — ëshë opium i popullit».

Përpara lëvizjes kombëtare qëndronte detyra e luftës për pavarësinë dhe arësimin e vendit. Në atë kohë njerëzit progresistë të Shqipërisë — luftëtarët e Rilindjes — ngritën krye kundër Turqisë së sulltanit, që kurdiste

armiqësitë midis myslimanëve dhe të krishterëve si dhe kundër përpjekjeve për t'i asimiluar shqiptarët myslimanë dhe për t'i bërë turq.

«S'ka turk e kaur, po janë gjithë shqipëtarë» shkruan Samiu.

Mendimtari dhe iluministi Sami Frashëri, megjithëse nuk shkoi deri në konkluzione të hapura ateiste, prapsepaprë ditë të kuptoja, dhe të dënojë rolin reaksionar të fesë dhe rrjedhimet e saj të tmershme.

«Grindat' e besësë, — shkruan ai — të cilatë, jo vetëm në vëndet e Lindjesë po edhe në Evropë e në vënde të ndritura me qytetëri, shumë herë kanë nxjerrë vrasje të mbëdha e të tmeruara».

Samiu kritikoi ashpër besimtarët, që e kalojnë kohën me falje fetare.

«E shumta e njerëzve, që s'vlejnë për kurgjë — shkruan Samiu — jepen pas fesë për të gjetur ngushëllim».

Pikëpamjet e tij janë një grusht i fortë kundër theokratizmit të sulltanit dhe në fakt kundër vetë fesë.

Ai ishte deist, i çliruar nga fanatizmi mysliman i Lindjes dhe nga të gjitha paragjykimet fetare.

«Hipokrizia — thotë ai — është imitacioni i fesë».

Fetarët myslimanë reaksionarë i ndalonin myslimanët që të merreshin vesh me «kaurët». Patrioti Sami i vuri si detyrë popullit shqiptar që të bashkohet për çlirimin dhe lulëzimin e Atdheut.

«Mos vështroni — shkruan ai — bes' e fe; myslimanë, katolikë, ortodoksë, gjithë shqiptarëtë sa jan' e tek janë, janë vëllezërë. Gjithë duhetë të bashkohenë nënë fjamurit të shenjtëruarë të Shqipërisë! Ay shqipëtar, që lë vëllezërit e tij, e ndahetë nga shqipëtarëtë për t'u bashkuarë me armiqt e Shqipërisë, duke e hequrë prej bese, ay është trathëtor, është armik i kombit e i mëmëdheut».

Pikëpamjet e Sami Frashërit për disa çështje të ekonomisë së vendit

Në librin «Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhetë?» Sami Frashëri paraqit një sërë masash ekonomike të domosdoshme për zhvillimin e Shqipërisë. Marja e këtyre masave do të bënte që vendi ynë të hynte shumë shpejt në rrugën e zhvillimit industrial. Krahas me çlirimin e vëndit Samiu kërkoi të bëheshin reforma ekonomike në fushën e industrializimit dhe të zhvillimit të bujqësisë së vendit tonë. Një çështje themelore e borgjezisë së porsalindur së Shqipërisë në shekullin XIX ishte çështja e tregëtisë së jashtëme. Borgjezia kishte grumbulluar shuma të mëdha të hollash në duart e saj. Ajo donte të zhvillonte prodhimin industrial kapitalist. Sipas mendimit të Samiut shkaqet e prapambetjes ekonomike të Shqipërisë mund të përmblidhen në këto: së pari, në karakterin grabitqar të shtetit otoman dhe, së dyti, në konkurencën e mallrave të vendeve kapitaliste, që pengonin industrializimin e Shqipërisë.

Samiu ishte kundër konkurencës së kapitalizmit evropian. Ai kuptoi karakterin grabitës të shteteve kapitaliste. Demokrati Sami dënoi shfrytëzimin e popujve të vegjël nga fuqitë e mëdha borgjeze. Ja si ka shkruar ai:

«O vëllezër Shqipëtarë! Të mos na gjenjë si ata t'egërtit e Avstralis' e t'Afrikësë, që ven' Evropianët e i gënjejnë me ca ruaza e me ca dragole të qeltërtë a pasqyra të pafillta, e u marrinë vëndet e tyre nga döra. Të mos gënjej hemi edhe ne ashtu me ca copa pafillesh e qelqesh që s'vlejnë gjë fare, e të lëmë të drejtat e kombit e të mëmëdheut tonë në duar të të huajët e t'armikëvet tanë.»

Në këtë mënyrë Samiu, megjithëse jo thellësish, kuptoi dhe dënoi ashpër karakterin grabitqar dhe sklavëronjës të zgjedhës koloniale nga ana e shteteve kapitaliste.

Shtetet kapitaliste në atë kohë përpinqeshin ta pushtonin Shqipërinë dhe ta futnin atë nën sferën e influencës së tyre.

«Monarkia austro-hungareze dhe mbretëria italiane — ka shkruar gazeta «Pravda» në vitin 1912 — përfunduan në vitin 1897 midis tyre në Monce traktatin, që i detyronin ata të mbanin statutus quoniam-në shqiptare dhe që të kishin kujdes që «shqiptarët shqiponja» të mos delnin nga duart e kapitaleve të tyre».

Samiu shikoi varfërinë e popullit dhe dënoi pushtonjësit dhe konkurencën e fabrikantëve kapitalistë të Evropës. Por njëkohësisht ai tregoi rrugën e daljes nga kjo gjëndje e vështirë. Ai e kupto se vetëvendosja politike varet nga zhvillimi ekonomik, nga zhvillimi i industrisë dhe i bujqësisë kombëtare.

Në këtë mënyrë ai kërkonte zhvillimin industrial të Shqipërisë, duke filluar nga ndërtimi i hekurudhave dhe, në përgjithësi, i komunikacionit. Samiu vuri si detyrë që të shfrytëzoheshin pasuritë e tokës dhe të nëntokës. Zhvillimit të bujqësisë ai i jepte një rëndësi të madhe.

«Ka fusha të gjëra — shkruan ai — nëpër të cilat rjedhinë lumënj që mundinë t'i ujtinë e t'i bëjnë kopshte, po sot për sot nga të qënëtë pa zot, i mbytinë e i bëjnë moçale. Vetëm fush' e Myzeqesë është mjaft t'ushqenjë gjithë Shqipërinë, po të hapenë lumenjtë».

Mendimi dhe ëndëra e demokratit dhe patriotit Sami Frashëri u vu në jetë vetëm në pushtetin popullor.

Në vendin tonë nën udhëheqjen e Partisë së Punës së Shqipërisë procesi i industrializimit po shkon me hapë të shpejta. Në pushtetin popullor është ngritur një industri krejt e re, e cila jep tanë gjysmën e prodhimit të përgjithshëm të vendit dhe që në më pak se 15 ditë ajo prodhon aq sa prodhohej gjatë tërë vitit 1938.

Bujqësia jonë ka bërë gjithashtu përparime të mëdha sidomos mbas kolektivizimit.

Qytete të reja po ndërtohen, po ngrihen hidrocentrale, uzina, fabrika dhe objekte të reja. Populli liridashës, për të cilin ëndëroi Samiu u bë zot' i vërtetë i vendit të vet.

Programi arësimor i Sami Frashërit

Ideologët e lëvizjes kombëtare të shekullit XIX i dhanë rëndësi të madhe zhvillimit të arësimit dhe të kulturës në vendin tonë. Dihet se në këtë kohë dhe deri në çlirimin e vendit shumica dërmonjëse e popullsisë në Shqipëri ishte analfabete. Në atë kohë në Shqipëri kishte vetëm tri shkolla fillore në gjuhën shqipe. Sami Frashëri propozoi që të hapen të tilla kudo në gjithë Shqipërinë. Programi i Samiut për arësimin dhe kulturën ishte madhështor. Ai kërkonte që arësimi dhe kultura të përhapeshin në gjithë popullin. «Edhe bariu edhe bujku edhe mjeshtri i mureve — shkruan Samiu — do të mos jenë pa dituri». Ai kërkoi arësimin fillor të detyruar për gjithë fëmijëtë nga 7 deri në 13 vjeç si për djemtë ashtu dhe për vajzat. Ai mendoi të hapeshin 2000 shkolla fillore (një shkollë për çdo 1000 banorë). Iluministi Sami Frashëri propozoi gjithashtu të hapen 30 gjimnaze dhe shkolla të mesme profesionale.

«Mësimi — shkruan Samiu — do të jetë pa ndonjë pagesë edhe të varfërët do t'u epenë edhe fletoretë e kartë etj. pa pagesë».

Samiu dëshironte që popullin e tij ta shikonte të kulturuar dhe të mësuar.

«Të hapimë shkolla, të mësojmë, të mos mbesë ndonjë shqipëtar i paditur e që të mos dijë të këndonj' e të shkruanë — thotë Samiu».

Ai propozoi hapjen e tre universitetave: një në kryeqytet, një në Shqipërinë e Veriut dhe tjetri në Shqipërinë e Jugut.

Ëndra e Samiut për hapjen e Universitetit në kryeqytet u realizua vetëm në pushtetin popullor. Gjithashtu



Samiu me gruan.

Samiu propozoi hapjen e shumë lloj instituteve, të Akademisë ushtarake, të Akademisë detare dhe të instituteve të gjuhëve të huaja. Ai gjithashtu kërkoi që të krijohej Akademia e shkencave, Muzeu Arkeologjik, Muzeu i shkencave të natyrës dhe Biblioteka Kombëtare.

Ai kuptoi mirë lidhjen e shkencës me punët praktike. Për këtë arësyen ai tha se midis Akademisë së shkencave dhe instituteve të ndryshme duhet të vendosen lidhje të ngushta me çdo ministri.

Samiu mbajti qëndrim të drejtë karshi çështjes së pakicës nationale në Shqipëri. Ai thotë se në ato vende, ku fliten dhe gjuhë të tjera përvèç shqipes, fëmijët në shkollat fillore do të mësojnë gjuhën e tyre edhe shqipenë bashkë, kurse shkollat e mesme dhe të larta do të jenë shqip.

Ky program i gjerë dhe kjo ëndër e ideologëve të shekullit XIX u vu në jetë vetëm pas revolucionit populor nën udhëheqjen e Partisë së Punës së Shqipërisë. Ata në ato kushte nuk mund të kuptionin se revolucioni kultural bëhet vetëm atëhere, kur klasa punëtore dhe masat punonjëse marrin pushtetin në duart e tyre. Samiu është mendimtar i thellë dhe edukator i talentuar. Ai na këshillon që të mësojmë pa pushim.

«Argëtimi më i këndëshëm për njerinë — shkruan Samiu — është studimi, dhe shoku më i mirë, libri».

Ai i kushtonte një vëmëndje të madhe edukimit, që e konsideron si faktor të rëndësishëm në përparimin e shoqërisë.

«Edukata — shkruan ai — nuk humb n'atë njeri, që e ka të kufizuar inteligjencën, por humb inteligjenca të i paedukuari».

Samiu gjithashtu i ka kushtuar kujdes edukimit të fëmijve. Ai thoshte se fëmija duhet të edukohet që sa lind dhe të mësojë që prej shtatë vjeç. Samiu nuk i nënçmonte punët e vogla, por ishte i mendimit se njerëzit, që kanë mundësi të kryejnë punëra të mëdha të mos ngarkohen me punëra të vogla. «Nuk ka gabim më të madh — shkruan ai — se sa të përdorësh për punë të vogla atë që i vijnë për done punë të mëdha».

Samiu punoi dhe luftoi pa u lodhur deri në minutat e fundit të jetës së tij. Ai i qmoi njerëzit jo nga pasuritë dhe nga postet që kishin, por nga veprat e tyre. «Veprat — shkruan ai — e bëjnë të pavdekshëm njerinë».

Sami Frashëri shkroi një libër të veçantë mbi kritikën dhe autokritikën me titull: «Principet e kritikës».

Ai mendonte se njeriu që bën gabime duhet të pësojë dënimin përkatës, ndryshe nuk përmirësoshet.

«Njeriu — shkruan ai — po nuk pësoi dënimin e fajeve të veta nuk pendohet».

Samiu kuptoi rëndësinë e madhe të artit në jetën shoqërore.

«Shkalla e qytetërimit dhe e moralit të një populli — thotë ai — njihet nga këngët e nga lodrat e tij».

Problemi i gruas

Një nga çështjet kryesore të pikëpamjeve sociale të Sami Frashërit është problemi i gruas. Këtë çështje ai e ka rrahur më gjérë në veprat e tjera. Për karakterizimin e pikëpamjeve shoqërore të Samiut interesant është traktati jo i madh me titull: «Gratë» (Kadënnlar). Akademiku i njohur sovjetik Vladimir Aleksandrovic Gordlevskij në librin e tij me titull «Përshkrim i literaturës së re turke» të shkruar në vitin 1912, e karakterizon kësh-tu Samiun: «Autori (d. m. th. Samiu — E. R.) — shkruan ai — e analizon me kujdes çështjen e gruas. Largimin e myslimankës ngajeta shoqërore — (të ashtuquajturën «mesturjeme») ai e thotë tërthorazi me qëllim që të mos ndalohej nga censura».

Traktatin mbi gratë Samiu e shkroi duke pasur parasysh prapambetjen e shoqërisë turke në krahasim me atë të Evropës.

Në Lindje, sidomos në Turqi, feja myslimanë, që, si-pas Kuranit, thoshte se «gratë tuaja janë ara për ju»:

«shkoni në arë, kur të dëshironi», shkaktoi influencën më të dëmshme në gratë.

Sami Frashëri foli për barazinë e të drejtave të grave me burrat. Ai kritikoi ashpër ata njerëz, që thoshin se gjoja shkaku i gjithë fatkeqësive janë gratë. Samiu i revoltuar shkruan: «Disa letrarë janë kundër grave dhe thonë: Gratë megjithëse s'kanë asnje fuqi e influencë, bëjnë në këtë botë kaq të këqia, por ç'farë do të bënin sikur të kishin fuqinë e influencën e burrave! E ne themi: Burrat duke qënë kaq të zotët e dijës e të eksperiencës bëjnë kaq të këqia e ç'farë nuk do të bënin sikur të kishin injorancën e mungesën e eksperiencës së grave! Ose sikur të kishin gratë influencën, zotësinë, dijen e eksperiencën e burrave, vallë do të ndodhëshin në botë kaq të këqia?».

Sami Frashëri, me anën e veprës letrare, me romanin «Telati dhe Fitneti», ka shprehur protestën kundër zakoneve turke të martesës. Në dramën «Besa» Zyberi e këshillon të bijën e vet Merushen që të mos martohet me njerëz të atillë si Selfon, djalë beu, i cili sillet sa andej këndej pa punë dhe që rron në kurriz të të tjerëve. Ai e porosit bijën e tij që të mos gënjejhet nga fustanet dhe pallaskat e argjënta të këtyre njerëzve. «Kurrë — i thotë Zyberi Merushes — mos u vërë sy fustaneve, pallas-kave t'argjënta të këtyre njerëzve!... Që pari nuk të thashë: cilën të pëlqesh do të ta ap? Në është se do të pëlqeq ndonjë njeri të tillë, ta dish mirë që s'të ap ne ay! S'dua të zë miqësi me të tillë njerëz të mefshtë, e pa punë! Një punëtor do pëlqyerë, bijë, një punëtor! Një bari, a një bujk! e more vesh bijë?».

Samiu ishte kundër martesave, që bazoheshin në pasuritë dhe në shtresat e larta shoqërore. «Martesa në lakmi të pasurisë së gruas — shkruan ai — është një tregëti. Martesa në lakmi të bukurisë është një aventurë. Martesa në lakmi të një pozite të lartë, të të afërmve të saj është një robëri. Martesa në lakmi të nderës së saj është të tregohesh i bindur e i kënaqur ndaj fatit. Martesa e vërtetë është ajo që bëhet me zgjedhje e me dëshirë».

Ai ishte përkrahës i edukimit dhe i mësimit të gra-

ve. Pikëpamjet e tij progresive duken kudo në lidhje me rolin e madh të grave në jetën shoqërore. «Lumturija e një kombi — shkruan Samiu — varet nga edukata e fëmrave».

Gjëndjen e mjeruar të grave në Orient e kanë kritikuar shumë njerëz përparimtarë. Pa dyshim se pikëpamjet e Sami Frashërit dhe të mendimtarëve të tjera mbi gruan janë shumë progresive në kushtet e shoqërisë orientale, ku gruaja ka qënë shumë e shtypur. Por dihet se gruaja çlirohet, kur merr pjesë në prodhim dhe kur lehtësohet nga punët shtëpijake.

«Clirim i gruas — shkruan F. Engelsi — do të mund të bëhet vetëm atëhere, kur ajo do të mund të marrë pjesë në prodhim në një shkallë të gjërë, në një shkallë shoqërore, dhe kur do të merret me punët e shtëpisë në një masë të vogël».

Sidoqoftë pikëpamjet e Samiut në kushtet e gjëndjes së rëndë të grave në Lindje kanë karakter përparimtar. Ai e kritikon sundimin e burrit mbi gruan. Këtë ai e quan si një veti jo burrërore.

«...Burri — shkruan ai — që do të jetë sundues mbi gruan ka humbur cilësinë e burrit».

Pikëpamja e Sami Frashërit, pa tjetër, është një hap përpara, por, sidoqoftë, ka karakter borgjez.

«Burri — shkruan F. Engelsi — sot duhet në shumicën e rasteve të fitojë, të ushqejë familjen, të paktën në rrëthin e klasave të pasura, dhe kjo i jep burrit një pozitë sunduese, që nuk ka nevojë për asnjë privilegj juridik të veçantë. Ai në familje është borgjezi, gruaja përfaqëson proletariatin».

Çështja e fshatarësisë

Sami Frashëri tregoi vëmëndje dhe vuri në dukje gjëndjen e vështirë të fshatarësisë. Ai revoltohet dhe

proteston kundër varfërisë së fshatarëve dhe kundër tak-save të mëdha, që u merreshin atyre.

«Të shpëtojnë fshatarët e varfër — shkruan ai — nga pagesatë q'apënë për vetëhe, për bagëtit, për dhet' e për shtëpit' e tyre, pagesa, që po u thyejnë meze e s'i lanë të marrë në frymë».

Këtë çështje, ai e ka rrahuur edhe në vepra të tjera. Në dramën «Besa», që u kushtohet fshatarëve shqiptarë, është karakteristike se herojt dhe njerëzit e saj janë nga shtresat e ulta të fshatit — barinj të varfër. Samiu fshatin e paraqet dhe e idealizon nga pikëpamja romantike, që ishte karakteristikë e romantizmit borgjez të shekullit XIX. Samiu si demokrat proteston kundër padrejtësisë shoqërore. Ai në këtë vepër flet me urrejtje kundër bejlerëve dhe çifligarëve dhe me ndjenja simpatije e aqimërimi flet për popullin e thjeshtë, për barinjtë.

Në thirrjen turqisht botuar më 23 prill 1899 me titull «Ujanallëm» («Të zgjohemi!») — kushtuar shpirtit të kulluar të Abdyl Frashërit — shprehet urrejtja e madhe kundër bejlerëve të cilët ndihmonin qeveritarët turq për të shtypur popullin shqiptar.

«O bejlerë, o njerëz oxhaqesh — thuhet në këtë thirrje — ky popull të cilin ju jeni duke e marrë nëpër këmbë, juve do t'ju drejtojë armët më parë».

Kjo thirrje nga përbajtja dhe nga stili ka mundësi dhe duket të jetë shkruar nga Sami Frashëri.

Në kushtet kur borgjezia ishte akoma e dobët dhe nuk ishte në gjëndje të luftonte për pushtet, Samiu nuk mundëte të shikonte ndarjen në klasa të shoqërisë. Në këtë mënyrë del se konflikti lind jo mbi bazën sociale, por më tepër për shkaqe sentimentale. Sidoqoftë idetë e Samiut kanë karakter demokratik. Ai lavdëron moralin e lartë të njerëzve të varfër, revoltohet dhe proteston kundër padrejtësisë shoqërore. Ja si e çfaq ai mendimin dhe pi-

këpamjen e tij nëpërmjet personazhit të fshatarit të varfër — Zyberit:

«Kështu është nisur kjo e shkreta jetë! Njeri zë punën pa gdhirë dhe mezi fiton një copë bukë me djersët të ballit, një tjetër që është i lik pér téré njerëzinë, pa punuar, pa munduar fare, pi e prëhet, dhe ha gjën' e dhetë njerëzve».

Samiu nuk flet pér shfrytëzimin, që bëjnë feudalët dhe çifligarët mbi kurriz të fshatarëve të varfër. Çështja kryesore e fshatarëve ka qënë toka, po pér dhëni e tokës fshatarëve, Samiu nuk bën fjalë fare. Megjithatë, kjo nuk do të thotë aspak se ai ishte me anën e çifligarëve, sepse të gjitha masat që ai propozonte të çonin në likuidimin e regjimit feudo-ushtarak.

Kjo mund të shpjegohet me këto arësy: së pari, nga botëkuptimi i tij borgjez dhe së dyti, nga detyrat imediatë konkrete historike të luftës pér pavaresinë e Shqipërisë. Duke pasur parasysh këto detyra historike, ai dhe gjithë rilindasit e tjerë bashkëkohës luftuan pér arritjen e qëllimit të parë — çlirimt të Shqipërisë. Pér këtë qëllim kryesor ata donin të grumbullonin gjithë forcat e vendit. Por Sami Frashëri, duke protestuar kundër padrejtësisë shoqërore kërkon dhe rrugëdalje.

«Sikur të punonin që të gjithë — thotë Samiu në personin e Zyberit — sa do t'ish mirë, nuk do t'i dihej as emri varfërisë».

K O N K L U Z I O N

Vellezërit Frashëri (Abdyli, Naimi dhe Samiu) zënë një vend të nderuar dhe të rëndësishëm në radhët e një-rëzve të shquar të Rilindjes kombëtare të gjysmës së dytë të shekullit XIX. Ata luftuan për çlirimin, arësimin dhe të ardhmen e lumtur të Atdheut. Populli shqiptar, që i nderon shumë dhe që përulet përpëra kujtimit të tyre, nën udhëheqjen e Partisë së Punës së Shqipërisë — shkon përpëra me besim dhe vë në jetë ëndërat dhe dëshirat e tyre.

Njeri nga njerëzit më të rëndësishëm dhe ideologu më i shquar i lëvizjes kombëtare të fundit të shekullit XIX është patrioti i flakët, i luministi, demokrati dhe mendimtari Sami Frashëri. Veprat e tij të shumta vërtetojnë dijen e tij të gjithanëshme dhe të thellë. Megjithëse jetonte larg nga populli i tij, ai e njihte mirë jetën e tij të vështirë dhe vuajtjet e shkaktuara nga pushtuesit turq.

Aktiviteti i tij i gjithanshëm teorik ishte i lidhur ngushtë me detyrat e luftës praktike, me çlirimin e Shqipërisë nga zgjedha turke, me demokratizimin, dhe zhvillimin e vendit. Ai ishte kundër absolutizmit dhe feudalizmit, që sundonte në perandorinë turke. «Për dituri — ka thënë shoku Enver Hoxha — luftonte Samiu i pavdekshëm».

Iluministi, mendimtari, demokrati dhe revolucionari Sami Frashëri i njihte zbulimet e mëdha shkencore dhe rrymat e ndryshme filozofike. Në qendrën e vëmënjes së Samiut ishin materialistët e Greqisë së vjetër dhe veganërisht iluministët dhe materialistët francezë. Ai gjithashtu çmoi shumë kontributin, që ka dhënë kultura

e popujve të Lindjes në pasurimin e thesarit të shkencës dhe të kulturës botërore.

Ai ngre lart kontributin, që kanë dhënë arabët dhe popujt e Lindjes në lëmet e ndryshme të shkencës si në matematikë, në gjeografi, në shkencat e natyrës, në astronomi dhe në mjekësi.

Samiu kishte respekt të madh për Ibni Sinën (Avicenën), të cilin ai e quante si dijetarin më të madh arab.

Në veprat e Samiut ne gjejmë elemente të materializmit dhe të dialektikës në kuptimin e zhvillimit të natyrës, të cilat kanë karakter spontan, por mbështeten në shkencat e natyrës.

Lind pyetja, se në q'mënyrë u formuan veçanti e materializmit spontan natyral-shkencor të botëkuptimit të Sami Frashërit të mbështetur në shkencat e natyrës? Dihet se shumica e natyralistëve, duke u nisur nga shkenca, në mënyrë të pandërgjegjëshme, arriten në bindjen se bota e jashtme ekziston objektivisht dhe se ndërgjegja e jonë nuk është gjë tjetër, veçse pasqyrimi i saj. Kjo bindje materialiste e pandërgjegjëshme quhet materializëm natyral-shkencor. Po kështu Samiu, duke u nisur nga të dhënat e shkencës, arriji në disa konkluzione materialiste, që e conin përpara shoqërinë e prapambetur, ku ai jetonte. Në perandorinë turke (duke përfshirë dhe Shqipërinë) sundonin në përgjithësi akoma marrëdhëniet feudale në prodhim, të cilat pengonin zhvillimin e marrëdhënieve kapitaliste të porsalindura.

Në këtë mënyrë Samiu në atë kohë, duke qënë në lidhje të ngushtë me njëzet përparimtarë të Turqisë dhe nën influencën e ideve përparimtare të ideologëve të revolucionit borgjez dhe të materialistëve në Francë e gjekë, kërkonte demokratizimin e vendit. Kështu që veçoritë materialiste dhe dialektike në botëkuptimin e Samiut lindën si rezultat logjik i reflektimit të marrëdhënieve kapitaliste, që kishin filluar të zhvilloheshin brenda në gjirin e shoqërisë së vjetër feudale dhe si rezultat i influencës si ideve përparimtare.

Duke u mbështetur në sukseset e shkencave të natyrës, Sami Frashëri tregoi nevojën e zgjerimit të prodhi-

mit. Thënia e tij që njerëzit duhet të njohin natyrën dhe të vërtetën e materjeve, që gjenden në botë e veçanërisht mbi lëmsh të dheut tonë, të dihet të përfitohet nga cilësitetë e atyre materjeve dhe të shtihen ato në punë përmirëqënen e mbarë njerëzimit, tregon se Samiu ishte për zhvillimin e mëtejshëm të prodhimit. Ai ishte për zhvillimin industrial të vendit, për ndërtimin e rrugëve të komunikacionit, për shfrytëzimin e pasurive të nëntokës, për bonifikime në bujqësi, për hapjen e Akademisë së shkencave dhe për lidhje të gushtë të shkencës me prodhimin. Duke u bazuar në sukseset e shkencave të natyrës, Samiu njeh botën materiale dhe zhvillimin historik të natyrës. Ai ka besim në aftësitë njohëse të pakufizuara të mëndjes njerëzore dhe është kundër agnosticizmit. Ai ka bindje në njojjen e botës dhe thotë se në shkencë nuk ka rrugë, ku të mos kalojë njeriu.

Në botëkuptimin e Sami Frashërit ka elemente të dialektikës spontane në kuptimin e natyrës dhe të shoqërisë. Ai njohu zhvillimin e pandërprerë të natyrës dhe të shoqërisë. Lëvizjen Samiu nuk e shikonte si një shkak të jashtëm, por si një veçori të brendshme të materjes.

Ai përkrahu teorinë e Darvinit — sipas së cilës bota shtazore ka kaluar një rrugë të gjatë të zhvillimit evolucionar dhe se nuk ka qënë kurdoherë e tillë sikundër e shohim atë sot.

Në kushtet e atëherëshme të mbrapambetjes turke këto pikëpamje të Samiut ishin një hap i madh përpëra dhe një goditje e fortë kundër fesë. Samiu i kaloi kufitë kombëtare dhe lojti një rol të madh progresiv në zgjimin e popujve të perandorisë turke. Sipas S. Frashërit forca lëvizëse e zhvillimit të shoqërisë është arësimi, edukata, shkenca, zhvillimi i mendimit. Për këtë arësyje ai përpinqej të përhapte dijet midis popullit. Sigurisht kjo punë kishte karakter përparimtar. Por duhet theksuar se Samiu nuk e kuptoi dhe s'kish se si të kuptonte atë, që faktori vendimtar në zhvillimin e shoqërisë është mënyra e prodhimit; prandaj pikëpamja e tij mbi zhvillimin e shoqërisë kishte karakter idealist.

Por Samiu ishte bir i kushteve të përcaktuara të kohës së vet dhe prandaj tek ai ka dhe kufizim e mendime kontradiktore. Nga njera anë, duke u mbështetur në të dhënët e shkencave të natyrës, ai pranon e njeh botën materiale, kurse, nga ana tjetër, ai flet për një fuqi të mbinatyrëshme. Duke folur për domosdoshmérinë e zbulimeve qiellore, ai pohon se nuk ka frikë nga ateizmi, por këtë e bën «për të treguar forcën e zotit».

Sipas mendimit tonë, Sami Frashëri është deist, dhe, në kuptimin e natyrës, materialist spontan që bazohet mbi shkencat e natyrës.

Si deist ai e largon zotin nga shoqëria (kjo është një mënyrë kundër teokratizmit në Turqi). Samiu ishte optimist për jetën. Ai kishte besim në të ardhmen e njerëzisë dhe u shpreh kundër fatalistëve.

Ai e kuptoi historinë e njerëzve si zhvillim në ngritje nga më e ulta tek më e larta, si një proces të pandërrerë. Por ai nuk mundi të zbulonte shkakun e vërtetë të zhvillimit, sepse ai nuk kuptoi zhvillimin si luftë të kundërtash. Kështu ai nuk mundi dhe s'mund të kuptonte se lufta e klasave është shkaku kryesor i zhvillimit të shqërisë me klasa.

Samiu i urrente fajdexhijtë dhe parazitët e tjerë të shoqërisë feudale, por ai sigurisht nuk mund të kuptonte se shfrytëzimi i njeriut nga njeriu është një fenomen social dhe jo një luftë e thjeshtë individash. Ai nuk mundi të kuptonte këtë, sepse në atë kohë në Turqi dhe në Shqipëri klasa punëtore akoma ishte shumë e pakët dhe se në këto vende sundonin më tepër marrëdhëniet feudale në prodhim.

Sami Frashëri shkon po n'atë rrugë, që shkuan iluministët dhe materialistët francezë të shekullit XVIII. Por kushtet specifike të zhvillimit të Shqipërisë kondicionuan edhe originalitetin e pikëpamjeve sociologjike të Samiut. Kështu nga njera anë ai foli për luftën e vendosur nacional-çlirimtare të popullit shqiptar dhe bëri thirrje për kryengritje të armatosur në rast se nuk do të fitoheshin të drejtat, kurse nga ana tjetër, ai èndëroi të bënte transformimin industrial jo me anën e revolucionit social, por

me anën e reformave borgjeze. Ai nuk i kishte të qarta rrugët konkrete: sipas të cilave duhej të bëhej transformimi industrial i vendit. Prandaj nuk kërkoj të bëhej shpronësimi i feudalëve, megjithëse e kuptoi që ata nuk e lëshojnë pasurinë e tyre vullnetarisht.

Dihet se që të bëhet transformimi industrial i vendit duhet të merren në duar mjetet e prodhimit dhe push-teti politik. Samiu këtë nuk e kishte të qartë.

Samiu si përfaqësues i borgjezisë së porsalindur, i inteligjencës përparimtare dhe i masave analizon një radhë çështjesh ekonomike, politike dhe shoqërore që kanë rëndësi të madhe për kushtet konkrete historike të asaj kohe. Ai kritikoi ashpër absolutizmin dhe bazën e tij ideologjike — teokratizmin. Ai ishte kundër strukturës feudale dhe kerkonte demokratizimin e vendit. Samiu ishte përkrahës i fortë i rendit demokratik republikan të tipit të demokrative borgjeze të vendeve evropianë të asaj kohe. Kjo sigurisht ishte përparimtare për atë kohë. Ai si patriot i flaktë, mbrojti të drejtat e atdheut të tij dhe dëshironte me gjithë zemër lumturinë e popullit të vet, të cilin ai e donte dhe e respektonte shumë.

Samiu urrente pushtonjësit turq dhe çfarëdo push-tonjës tjetër. Ai demaskoi karakterin grabitës të kapitalit të huaj dhe u përpooq t'i tregonte popullit të vet rrugën e daljes nga gjëndja e vështirë. Ai e donte shumë Atdheun e vet dhe interesat e popullit i vuri më lart se interesat personale. Ai dënoi ashpër pikëpamjet oportuniste dhe tradhëtare.

Demokrati dhe mendimtari Sami Frashëri bëri dallim midis popullit turk dhe klasave sunduese të Turqisë. Asnjë nga veprat e tij nuk i ka shërbyer regjimit despotik të sulltanit, por përkundrazi veprat e tij i kanë shërbyer çështjes së ndriçimit të lirisë dhe të çlirimt të popullit nga zgjedha e absolutizmit të sulltanit.

Veprat e Naimit, të Samiut dhe të rilindasve të tjerë edukuan masat e gjëra të popullit si dhe një plejadë patriotësh me ndjenjat e zjarrta të dashurisë dhe të sakrificës për atdheun.

Populli shqiptar ndoqi rrugën revolucionare të rilindasve, rrugën e çlirimit të Atdheut nga pushtonjësit dhe nga shtypësit. Në nëndor të vitit 1912 ai shpalli pavarësinë e tij. Në 1920 në Vlorë hodhi në det imperialistët italiannë, më 1924 bëri revolucionin demokratiko - borgjez dhe më vonë luftoi vazhdimisht kundër regjimeve të urryera antipopullore të Zogollit dhe të kuislingëve fashistë.

Por Lufta Nacional-Çlirimtare, që u bë nën udhëheqjen e Partisë, është epopeja më e ndritur e popullit tonë.

Populli shqiptar për herë të parë në historinë e tij me luftë të ashpër që bëri kundër pushtonjësve dhe trahëtarëve më 29 nëndor të vitit 1944 fitoi lirinë e vërtetë dhe vendosi demokracinë popullore.

Partia e Punës dhe Pushteti Popullor kanë çmuar, kanë ngritur lart dhe kanë përvetësuar traditat e shkëlqyera të popullit tonë paqëdashës dhe punëtor. Endërat e Sami Frashërit dhe të rilindasve të tjerë revolucionarë u vunë në jetë në Pushtetin Popullor.

B I B L I O G R A F I A

I. Vepra të klasikëve të marksizëm-leninizmit

- K. Marks dhe F. Engels, Arkivi i Marksit dhe i Engelsit, Moskë, viti 1939, botim rusisht, vëllimi VI.
- K. Marks dhe F. Engels, Çështja e Lindjes, Veprat — botim rusisht, Moskë, viti 1933, vëllimi IX.
- K. Marks dhe F. Engels, Veprat, botim rusisht, viti 1933, vëllimi XV.
- K. Marks dhe F. Engels, Veprat e zgjedhura në dy vëllime.
- K. Marks dhe F. Engels, Mbi fenë, Moskë, viti 1955.
- K. Marks dhe F. Engels, Kritika e programit të Gotës, vepër të zgjedhura, vëllimi II.
- F. Engels, Anti-Dyrring, botim i vitit 1953.
- F. Engels, Roli i punës në procesin e transformimit të majmunit në njeri. Botim i vitit 1952, Vepra të zgjedhura, vëllimi II.
- F. Engels, Origjina e familjes, e pronës private dhe e shtetit, botim i vitit 1952, Vepra të zgjedhura, vëllimi III.
- F. Engels, Zhvillimi i socializmit nga utopia në shkencë, Vepra të zgjedhura, vëllimi IV, botim shqip.
- K. Marks dhe F. Engels, Vëllimi XIX, botim rusisht.
- V. I. Lenin, Fletoret filozofike, botim rusisht i vitit 1947.
- V. I. Lenin, Ngjarjet në Ballkan, vëllimi 15.
- V. I. Lenin, Materializëm dhe empiriokriticizëm.
- V. I. Lenin, Rëndësia e materializmit luftarak, vëllimi 33.
- V. I. Lenin, Mbi shtetin, vëllimi 29.
- J. V. Stalin, Marksizmi dhe çështjet e gjuhësisë.
- J. V. Stalin, Çështje të leninizmit.

II. Vepra të udhëheqësve të partive komuniste e punëtore.

- E. Hoxha, Populli shqiptar për paqë dhe socializëm, botim rusisht i vitit 1956.
- M. Shehu, Fjalimi me rastin e 45 vjetorit të shpalljes së pavarësisë në Vlorë.
- M. Myftiu, Fjalim i mbajtur me rastin e hapjes së universitetit të Tiranës.

III. Vepra origjinale të Sami Frashërit.

A. Në gjuhën shqipe:

- S. Frashëri, Gjuha shqipe, Bukuresht 1879.
- S. Frashëri, Dheshkronja, Bukuresht 1879.
- S. Frashëri, Alfabetare e gjuhës shqipe, Bukuresht 1886.
- S. Frashëri, Gramatika e gjuhës shqipe, Bukuresht 1886.
- S. Frashëri, Shqipëria ç'ka qënë, c'është e çdo të bëhetë? Tiranë, 1923.
- S. Frashëri, Besa, Tiranë 1937 (përkthim nga turqishtja).

B. Në gjuhën turqishte:

a) Vepra të shkencave të natyrës.

- | | |
|--------------------------------------|---|
| S. Frashëri, Qielli, Stamboll, 1880. | S. Frashëri, Emsal (proverba filozofike),
shkrim nga Instituti Stamboll 1880. |
| S. Frashëri, Toka, Stamboll 1880. | Janë përkthyer dorë historisë dhe i gju- S. Frashëri, Qytetërimi Islam, Stamboll,
hësisë 1886. |
| Shkrim nga Institut Stamboll 1880. | S. Frashëri, Gratë, Stamboll 1895. |
| historisë dhe i gju- 1886. | |
| S. Frashëri, Gjuha, Stamboll 1887. | |
| S. Frashëri, Gratë, Stamboll 1895. | |

b) Vepra leksikologjike

- S. Frashëri, Parathënie në Enciklopedinë turke, Stamboll 1889-1899.
- S. Frashëri, Fjalori biografo-gjeografik (Enciklopedia) në Turqisht.
- S. Frashëri, Fjalori turqisht-frëngjisht, Stamboll 1885.
- S. Frashëri, Fjalori frëngjisht-turqisht, Stamboll 1901.
- S. Frashëri, Fjalori i gjuhës turke (parathënie) Stamboll 1901.

IV. Dokumenta të Arkivit Qëndror të Shtetit të R. P. Sh.

- S. Frashëri, Letra dërguar G. De Radës, Stamboll 20 shkurt 1881.
- S. F. dhe N. Frashëri, Letra dërguar Murat efendi Toptanit, Stamboll, 27 dhjetor 1898.

V. Literaturë e përgjithshme për S. Frashërin

a) Në Shqipëri.

- Dh. Shuteriqi, Letërsia e re shqipe, Tiranë 1951
- Z. Sako, S. Frashëri shkrimitar i përparuar dhe patriot i Rilindjes. Revista «Letërsia e jonë» Tiranë 1950. Nr. 6.

K. Frashëri, Sami Frashëri «Buletini i Institututit të shkencave të Shqipërisë Nr. 3 viti 1955.
K. Frashëri, Lidhja e Prizrendit, Tiranë 1956.

Instituti i Historisë
dhe gjuhësisë,

Historia e Shqipërisë,

V. Pasha, E drejta për Shqipërinë dhe shqiptarët, Tiranë 1935.

b) Në vënde të tjera

- Akademiku Vl. Gordlevskij, Përshkrime të letërsisë së re turke, Moskë 1912 (në rusisht).
Kramers, Enciklopedia e islamit në frëngjisht dhe gjermanisht, Enciklopedia italiane, Milano, 1936 vëll. XXX.
U. Akçora, Shemsedin Sami.
N. Turhan, Shemsedin Sami.
D. Kelikjan, Shemsedin Sami bij Frashëri, Parathënie, Stamboll, 1911 (në frëngjisht).

Literatura nga filozofë të ndryshëm.

- G. V. Plehanov, Përshkrime mbi historinë e materializmit. Moskë, 1956, V. II.
E. Kant, Prolegomenët, veprat, vëll. II.
V. F. Asmus, Filozofia e Kantit, Moskë 1957.
Dekart, Discours de la méthode.
Dekart, Istorya narodov SSSR.
Lametri, Vepra të zgjedhura (botim rusisht).
Darvin, Origjina e specieve.
Cernishevskij, Vepra filozofike të zgjedhura.

Shtypi periodik

- «Pravda» 28 dhe 29 nëndor 1912.
«Zeri i Popullit»
Gazeta «Drita», Sofie, viti III Nr. 46 14 qershori 1904.

PËRMBAJTJA

Faqe

Hyje	3
------------	---

KAPITULLI I

JETA DHE VEPRAT E SAMI FRASHËRIT	9
--	---

KAPITULLI II

PIKËPAMJET FILOZOFIKE TË SAMI FRASHËRIT	15
---	----

Veçoritë kryesore të botëkupëtimit të S. Frashërit	16
Tiparet materialiste në botëkuptimin e S. Frashërit	19
Zhvillimi historik i botës	25
SAMI FRASHËRI mbi origjinën e njeriut	27
Gjuha dhe mendimi	31
Elemente të dialektikës në veprat e S. Frashërit	34

KAPITULLI III

PIKËPAMJET SHOQËRORE-POLITIKE TË SAMI FRASHËRIT	39
---	----

Përbajtja dhe idetë kryesore të librit «Shqipëria ç'ka që-në, ç'është e ç'do të bëhetë?»	44
Kushtetuta e shtetit të ardhshëm indipendent të Shqipërisë	48
Shteti dhe feja	52
Pikëpamjet ekonomike të S. Frashërit	54
Programi arësimor i S. Frashërit	56
Problemi i gruas	58
Cështja e fshatarësisë	60
Konkluzion	63
Bibliografia	69

JANË NË QARKULLIM
Letërsit Politiko-Shoqërore

		Lekë
L. Dilo	— Çerçiz Topulli me shokë	15
Vaso Boshnjaku	— Misto Mame	15
Vaso Boshnjaku	— Alqi Kondi	15
Hemit Beqja	— Revolucioni ynë kultura	20
Bejxhe Myftiu	— Hamid Shijaku	10
Ymer Minxhozë	— Ishulli kryengritës (Kuba)	20
Pipi Mitrojorgji	— Histori e shkruar me gjak	45
Izet Bajramaj	— Gana shtet i pavarur afrikan	15
Izet Bajramaj	— Republika e Guinesë	15
— — — —	— Ç'thonë amerikanët për mënyrën e jetesës amerikane	15
Irma Telman	— Ernest Telman	20
Esat Reso	— Naun Prifti (Doko)	15
Alfred Uçi	— Përbajtja dhe karakteri i epokës së sotme	15
Q. Haxhihasani	— Thimi Mitko	25
Nuçi Tira	— Zbulime në shtrofshkën e fundit të armikut	35
Adli Dibra	— Lëvizja komuniste ndërkontaktare, forca politike më e madhe e kohës sonë	15
E. Jarosllavski	— Si lindin, jetojnë dhe vdesin personat e ditës dhe perëndeshat	40
A. J. Lurie	— Komunarët e Parisit	60

Çmimi 20 lek